

PROJEKT ZBATIMI

OBJEKTI: "RIKONSTRUKSION RRUGA "HAFIZ ALI ULQINAKU", BASHKIA SHKODËR

1. RELACION TEKNIK
2. SPECIFIKIME TEKNIKE
3. PREVENTIV PUNIMESH
4. ANALIZA ÇMIMESH
5. V.N.M

RELACION TEKNIK

OBJEKTI: "RIKONSTRUKSION RRUGA "HAFIZ ALI ULQINAKU", BASHKIA SHKODËR

RELACION TEKNIK

OBJEKTI: "RIKONSTRUKSION RRUGA "HAFIZ ALI ULQINAKU"

TË PËRGJITHËSHME

Pozicioni gjeografik

Qyteti i Shkodres shtrihet në pjesën veriore të Shqipërisë. Është qytet kufitar me qytetin e Ulqinit dhe Barit Podgorices ku si pikë kontakti është dogana e Muriqanit. Në brendësi të territorit shqiptar Shkodra kufizohet me Malesi e Madhe në veri, Tropojen në lindje dhe Vaun e Dejes në jug. Qyteti i Shkodres klasifikohet si Bashki dhe është qendër administrative e Prefekturës dhe e Qarkut të Shkodres, që përveç rrethit të Shkodres përfshin rrethet Malesi e Madhe, Puke, Fushe Arez dhe Vau Dejes. Zona ne studim e ketij qyteti eshte lagjia Shiroke rreth 0.1 ha.

Kushtet klimatike të bllokut

Zona e projektit, sipas ndarjes klimatike te Shqiperise, shtrihet ne zonen Mesdhetare Malore Kodrinore. Ne kete zone temperatura e ajrit karakterizohet nga vlera relativisht te larta. Temperatura mesatare vjetore e ajrit eshte 15.0 °C nderkohe qe temperatura mesatare e janarit (muaji i ftohte) eshte 4.6 °C dhe ajo e muajit gusht 25.1 °C.

Persa i perket reshjeve atmosferike regjimi i tyre ne kete zone ka karakter mesdhetar; sasia me e madhe e reshjeve bie gjate periudhes se ftohte te vitit ndersa me pak reshje bien gjate periudhes se ngrohte. Mesatarisht gjate vitit ne pellgun ujembledhes se lumit te Rrjollit bien rreth 1650 mm, nga te cilat 65 % e tyre bien gjate periudhes se ftohte te vitit. Muaji me i laget i vitit eshte muaji nentor, ne te cilin bien mesatarisht 238.0 mm ndersa muaji me i thate eshte muaji korrik ne te cilin bien vetem 36.3 mm.

Kushtet ambientale

E parë edhe në kënd-vështrimin e zhvillimeve të fundit urbane, kjo zonë që karakterizohet nga një dendësim te ulet popullsie me vilave 1-3 kat. Më problematike paraqitet çështja e ndotjes se ajrit nga pluhuri gjate levizjes se mjeteve, pasi rruget jane te pashtruara dhe te gjitha automjetet qe levizin ndosin ajrin dhe parkohen ne menyre te c'regullt duke bllokuar levizjen e lire te banoreve, bicikletave dhe automjeteve. Shtrimi i rrugeve, ndertimi i kanalizimeve dhe ndricimi i tyre do te risi sigurine e levizjes per banoret dhe do te uli ndotjen nga vershimi i ujrave te zeza ne rruge gjate rreshjeve te shiut.

GJËNDJA E INFRASTRUKTURËS EKZISTUESE

Situata e zhvillimit urban

Zona karakterizohet nga një zhvillim urban i objekteve të banimit. Vlen të theksohet se zhvillimi i aktiviteteve të shërbimit mungon në këtë segment. Ndërtimet para viteve '90 janë shtepi për dhese 1 kate me tulla të plota pjesërisht të suvatuar. Rrugët janë të pashtuara për të qenë zona urbane dhe ato kufizohen nga mure e gardhe pronash private. Ato nuk janë të konceptuara për kushtet e zhvillimit ekonomik, urban dhe social aktual. Kështu në shumicën e rasteve, gjërësia e rrugëve nuk i kalon 4.0 - 5.0 m.

Mbas viteve '90 u shfaqën shënjat e para të nevojës për shfrytëzimin e tokës duke zhvilluar ndërtime në lartësi. Në këtë periudhë janë dhënë leje ndërtimi në kopshte dhe toka bujqesore të zonës për vila 1-2 kate të cilat kanë ritur intesitetin e ndërtesave në zonë dhe kanë ulur disi gjelberimin.

Gjëndja e sistemit rrugor (rrugë-trotuare)

Infrastruktura rrugore ekzistuese, objekt i këtij studimi mund të përshkruhet me pak fjalë të inegzistente. Rruga ekzistuese është e pashtuar me asfalt dhe ato pak shtresa shavori janë hedhur nga banoret për të mbushur gropat ekzistuese. Gjëndja e tyre paraqitet tejte e amortizuar dhe kërkon nderhyrje me infrastrukturen e nevojshme.



Në pjesë të veçanta të rrugës, mungesa e rrjetit të ujërave të shiut ka bërë që të krijohen gropat të cilat mbushen me ujë në ditët me shi, ndërkohë nga pikpamja teknike mund të thuhet se mungojnë shtresat rrugore. Në kushtet ekzistuese zona nuk është lehtësisht e qarkullueshme edhe

ato pak automjete që kalojnë janë automjete të banorëve të lagjeve të cilat janë të detyruar të parkojnë afër banesave private.

Rruga ka nevojë të trajtohet nga pikpamja e ndertimit të infrastrukturës jo vetëm përsa i përket ndërtimit të shtresave rrugore por edhe për ndërtimin e rrjetit sekondar të kanalizimeve dhe ndërtimin e rrjetit të ndriçimit rrugor etj. Ato janë marrë në konsideratë në këtë projekt zbatimi.

Gjëndja e sistemit të kanalizimeve

Zhvillimi urban i zonës kryesisht në drejtim të shfrytëzimit të sipërfaqes së tokës nga objektet e banimit dhe shërbimit, rritjes së prurjeve të shkarkimit si rezultat i rritjes së numrit të popullsisë, i rritjes së numrit të mjeteve të transportit që kalojnë në zonë, si dhe faktorëve të tjerë të lidhur kryesisht me mirëmbajtjen e rrugëve dhe kanalizimeve kanë kontribuar në degradimin e rrugëve dhe sistemit të kanalizimeve të ujrave të zeza në këto tre rrugica.

Ndërtimet e reja kanë kontribuar gjithashtu edhe në rritjen e prurjeve të ujrave të bardha si rezultat i pakësimit të sipërfaqeve të gjelbëra në zonë dhe zëvendësimit të tyre me sipërfaqe të zhveshura. Përsa i përket rrjetit të kanalizimeve të ujrave të shiut, gjëndja e rrjetit ekzistues paraqitet me probleme. Mungon totalisht rrjeti i ujrave të bardha dhe uji i shiut rrjedh në rrugë duke penguar levizjen e lire të njerezve dhe duke demtuar rrugën e automjeteve.

Kjo ka rënduar më tej kushtet e rrugëve duke bërë që trafiku që kalon në to të kontribuojë më tej në prishjen progresive të tyre dhe të infrastrukturës rrugore. Kjo ka bërë që edhe pusetat e kolektorëve të kanalizimeve të ujrave të zeza të kenë pësuar çedime dhe të perzien me ujrat e shiut të cilat filtrojnë. Në gjëndjen aktuale siç është sistemi i kanalizimeve funksionon me probleme.

Gjëndja e rrjetit të ndriçimit dhe atij elektrik

Në gjëndjen ekzistuese, rruga mund të konsiderohet e ndriçuar. Përsa i përket rrjetit elektrik OSHEE sh.a. është rehabilituar duke instaluar fillimisht matësat e energjisë dhe duke ndërhyrë në transformatorët e fuqisë dhe pastaj në linjat ajrore të shpërndarjes 10-20 kV sipas planit të përgjithshëm të për rehabilitimin e rrjetit shpërndarës dhe uljen e humbjeve në sistemin elektro-energjetik.

Gjëndja e sistemit të gjelbërimit

Gjelberimi rrugor nuk ka ekzistuar pasi zona ka qenë rurale dhe ka qenë zëvendësuar nga gjelberimi i kopshteve dhe banesave private. Aktualisht gjelberimi në rrugë nuk ekziston përveç atyre brenda pronave private dhe nuk ka mundësi që të vendoset pasi gjëresia e rrugës është minimale.

Parkimet publike

Ne rrugica mungon parkimi publik. Shkak eshte se permasat e ketyre rrugëve jane te ngushta dhe nuk e mundesojne parkimin anes tyre. Banoret pergjithesisht kane garazhe individual ose parkojne brenda oboreve te shtepive private. Levizja ne keto rrugica eshte me nje sens dhe pa shesh per kthimin e automjeteve. Nuk ka mundesi per krijimin e sheshit te ndrimit pasi rruga eshte e ngushte, e shkurter dhe secili mund te kembehet te hyrja e banesen se vet.

Rrjeti telefonik kabllor i telefonisë fikse

Nga azhurnimi i bërë në teren rezulton se pjesa më e madhe e shtepive të banimit në zonë është e pajisur me telefon fiks me linja ajrore nga ana e AlbTelekomit Shqiptar dhe kompanive të tjera të cilat ofrojnë shërbimin e telefonise, internetit dhe televizionit. Nuk duket se ka ndonjë problem inxhinierik për t'u zgjidhur gjatë rikonstruksionit me përjashtim të marrjes së masave për mbrojtjen e sistemeve kabllore me funksion të shumëfishtë.

Nga ana tjetër, në mungesë të planeve të AlbTelekom-it Shqiptar për prespektivën e zhvillimit të telefonisë fikse në këtë zonë, dhe spostimi i linjave ajrore ne tokesore nuk ngelet gjë tjetër përveçse marrja e masave paraprake gjatë zbatimit të punimeve të ndërtimit në rrugë në mënyrë të tillë që të mos kërkohet nga ana e AlbTelekom-it çarja sërish e rrugëve të porsa bëra për shtrirje kabllorsh të rinj. Kjo do të thotë që, gjatë ndërtimit të rrugëve do të vendosen në pozicioni 'stand by' tuba plastike bosh në të dy anët e rrugëve si dhe tuba metalikë në kryqësim të rrugëve për çdo zhvillim të mëtejshëm të rrjeteve inxhinierikë kabllore nëntokësorë.

REALIZIMI I PROJEKTIT

TË PËRGJITHËSHME MBI OBJEKTIVAT E PROJEKTIT

Është hartuar projekti i rehabilitimit e rruges qe perfshin zonen e shtepive private si që synon të përmbushë objektivin e Bashkisë Shkoder, për rehabilitimin e infrastrukturës rrugore, sinjalistiken, K.U.Z., si më poshtë:

Projekti i infrastrukturës rrugore

Është hartuar projekti dhe preventivi për fazën e projektit te zbatimit, shoqëruar me raportet teknike, VNM dhe specifikimet teknike përkatëse, për rehabilitimin e rrugëve ekzistuese, në përputhje me planin detajuar vendor të përgatitur nga bashkia dhe në konformitet me kërkesat e veçanta për rrugët të përshkuara në detyrën e projektimit. Përveç planimetrisë së rrugëve dhe trotuarëve jepen edhe profilat gjatësorë të tyre së bashku me kuotat përkatëse të niveletave si në pikat e intersektimit të tyre me rrugët ekzistuese ashtu edhe në vëndet e thyerjes së niveletave.

Jepen gjithashtu edhe detajet e rrugëve nëpërmjet profilave tërthorë të tyre ku përveç komponentëve përbërës të trupit të rrugës me përmasat përkatëse jepen edhe detaje të nevojshëm për zbatim si distancat e rrugës nga objektet ekzistuese, etj.

Projekti i rehabilitimit të rrjetit kanalizimeve të ujrave të zeza

Rrjeti i furnizimit me uje nuk eshte perfshire ne kete projekt pasi ai eshte ekzistues dhe ne gjendje pune. Nga azhornimi me projektin qe do te zbatohen do te parashikohet mbingritja e pusetave te F.U.. Kanalizime e ujrave te zeza eshte bere i ri.

Kosto e projektit - preventivit të veprës për projektin e zbatimit

Për të gjitha punimet që do të kryhen në kuadrin e projektit është përgatitur preventivi i plotë i detajuar i ndarë sipas punimeve për fazën e projektit të zbatimit bazuar dhe në specifikimet teknike, duke marrë parasysh edhe kërkesat e veçanta të bashkisë në lidhje me standartet e pranuar për çdo nënobjekt dhe me çmimet e tregut të ndërtimit dhe të materialeve të ndërtimit të publikuara nga Keshilli i Ministrave për vitin 2015. Preventivi i detajuar së bashku me faqen përmbledhëse për çdo rrugë është paraqitur veças së bashku me fletët e vizatimit dhe me specifikimet teknike.

REALIZIMI I KËRKESAVE TE VEÇANTA TË PROJEKTIT


Për të realizuar një cilësi të lartë të zbatimit të punimeve të sistemimit dhe rikonstruksionit të infrastrukturës së zones ne studim gjatë hartimit të projektit, specifikimeve teknike dhe preventivit të veprës janë marrë parasysh dhe janë zbatuar kërkesat e veçanta të projektit të renditura këtu më poshtë:

Për komponentin ‘Rehabilitimi i Rrugëve dhe Trotuareve’

Rrugët

Rruga eshte trajtuar në përputhje me gjendjen aktuale, duke mare parasysh distancat ekzistuese dhe mos nderhyre ne prona private pasi per fluksin e mjeteve qe levizin keto rruge jane te mjaftushme.

Gjërësia e trupit të rrugës është marrë me kushtet e gjendjes aktuale 4.0 - 5.0 m. Materialet që do të përdoren do të jenë të gjitha sipas kushteve teknike të rrugëve. Materiali kryesor ndërtimor për nënshtresat e rrugës do të jetë çakëlli, stabilizanti, kurse për shtresat e sipërme të rrugës do të jetë binderi dhe asfaltobetoni.



Në një anë e rrugës do të ketë kuret ujëmbledhëse për grumbullimin e ujrave të shiut dhe për transportimin e tyre në pusetat e ujrave të bardha të rruges kryesore. Prej andej ato transportohen në pusetat e rrjetit të tubacioneve të ujrave të bardha në drejtim të kolektorëve kryesorë.

Shtresat e rrugës janë llogaritur dhe trajtuar në mënyrë të tillë që të sigurojnë garanci për rrugën, qëndrueshmëri dhe të përballojnë kapacitetet faktike dhe të perspektivës. Për trashësinë e shtresave të ndryshme që përbëjnë pjesën kaluese të rrugës shih prerjet tërthore në fletët e vizatimi për çdo seksion të tyre, ndërsa mënyrën e llogaritjes së shtresave rrugore shih paragrafin “Llogaritja e trashësisë së shtresave rrugore” në fund të këtij relacioni teknik.

Trotuarët

Trotuar është vendosur vetëm në segmentet ku ka parametra për të realizuar ato me gjerësi variabël deri 0.5m. Atje ku nuk ka qenë e mundur trotuarët, janë ndërtuar vetëm bordurat e rruges. Nëse në të ardhmen do të prishen muret rrethuese bordura kufizuese do të shërbejë si kufi mbrojtës i rruges që mos demtohet dhe do të ndërtohet trotuari në njerin krah.

Parkimi

Nga azhurnimi i gjendjes faktike të rruges nuk ekziston mundësia e parkimit të automjeteve anash tyre. Është llogaritur gjerësia minimale e rruges 3m dhe ndërtimi i trotuarit 0.5m dhe nuk

lejon ndertimin e parkimeve. Banoret e zones do te vazhdojne ti parkojne automjetet ne oboret e shtepiane ose ne rrugen kryesore.

Skema e qarkullimit rrugor

Gjërësia e rrugëve e nuk krijon plotesisht kushtet për lëvizje me dy kahje dhe eshte e nevojshme qe levizja ne zone te behet me nje drejtim dhe vend kembimi aty ku eshte e mundur gjeresia 5.0m ose ne hyrjet e banesave sepse rruga eshte e shkurter dhe e drejte qe lejon shikimin.

Për komponentin ‘Rehabilitimi i Kanalizimeve të Ujrave të Zeza’

Mbi skemën e përgjithëshme të kanalizimeve të ujrave të zeza

Nga inspektimet me specialistet e bashkise eshte verejtur se rrugicat kane nevojte per rrjet te ri kanalizimesh. Me hartimin e projektit te ri do te behet e mundur qe gjate punimeve te pastrohen linjat ekzistuese te familiareve te gjithe zones në studim.

Detajimi i nyjeve të rrjetit të kanalizimeve të ujrave të zeza

Është parashikuar ndertimi i ri i rrjetit te ujrave te zeza.

LLOGARITJET STATIKE, HIDRAULIKE DHE ELEKTRIKE

Llogaritja statike për përcaktimin e shtresave rrugore

Për rrugët, shtresat rrugore janë llogaritur për pjesën ekzistuese. Janë marrë për bazë të dhënat gjeologo-inxhinierike dhe gjeoteknike të zonës duke përcaktuar trashësitë e shtresave me anë llogaritjesh. Për këtë rast rrugët do të bëhen të reja duke filluar nga gërmimi për krijimin e kasetës së saj dhe duke krijuar trupin e rrugës me mbushje me shtresa të dhëna në profilet tërthore të rrugëve.

Përsa i përket rrugëve ekzistuese, një vizion i hollësishëm në terren është bërë nga ana e grupit të projektimit duke përcaktuar në vend shkallën e dëmtimit të secilit segment rrugor. U konstatua që në pjesën më të madhe, rrugët ekzistuese janë dëmtuar në shkallë të tillë sa trupi i tyre nuk mund të rehabilitohet.

Për pjesën ekzistuese të trupit të rrugëve, ato do te prishen te gjitha nga rrjeti inxhinierik, pastaj do të vendosen shtresa te reja të cakullit, stabilizantit, binderit dhe të asfaltobetonit.

Për pjesët e reja të rrugëve ekzistuese dhe rrugët tërësisht të reja, trashësia e shtresave rrugore është bërë me llogaritje analitike. Për llogaritjen e trashësisë së shtresave u morën parasysh gjeologjia e tokës e marrë nga studimi gjeologo-inxhinierik i trullit i cili ka ndryshime duke u

larguar nga unaza e qytetit në drejtim të spitalit. Koeficienti i deformacioni varion nga 80kg/cm² në 120kg/cm².

Dy proçedura janë ndjekur për të llogaritur shtresat rrugore: ajo sipas standartit AASHTO e bazuar në raportin mbajtës Kalifornian (CBR) dhe ajo e bazuar në koeficientët elastikë të shtresave ose e quajtur ndryshe metoda statike ose metoda DORNI ose metoda ruse.

Llogaritja sipas metodës klasike me modulet e deformacionit (metoda ruse):

Sipas kësaj metode bazuar në modulet e deformacionit të materialeve të ndryshme që përbëjnë trupin e rrugës përfshirë bazamentin llogaritet trashësia ekuivalente tokë që zëvendëson shtresat e mbushjes së trupit të rrugës dhe nga ajo trashësi e përgjithëshme përcaktohen trashësitë e shtresave sipas raporteve të moduleve të deformimit të secilës shtresë kundrejt asaj të asfaltit.

Variablat që marrin pjesë:

Ngarkesa G_{rr} e rrotës në rrugë në kg, që është ngarkesa që shkarkon mjeti në një rrotë me shkelje (gjurmë) d ;

Presioni i brëndshëm i gomës p_0 në kg/cm²;

Presioni specifik i rrotës mbi shtresë p në kg/cm² që llogaritet me formulën ku $\beta=1.05$;

Gjurma e rrotës në rrugë d e llogaritur nga formula $d = 1.06 \sqrt{\frac{G_{rrot}}{p_0}}$ (cm);

Të dhënat e shtresave (modulet e deformacionit) në kg/cm², $E_0=120(80)$, $E_1=3000$, $E_2=2000$ dhe $E_3=800$, respektivisht për tokën (bazamentin), asfaltobetonin, binderin, stabilizantin dhe çakullin;

Me të dhënat e mësipërme, shtresa ekuivalente llogaritet me formulën:

$$h_{ek} = \frac{d}{n} \times \cot \frac{71.6 \times E_0}{p \times d}$$

Me metodën e mësipërme kanë rezultuar trashësitë e shtresave të mëposhtëme:

Asfaltobeton 3cm;

Binder 4cm;

Stabilizant 10cm;

Çakull gurore 15cm;

Projektimi i shtresave rrugore me metodën moderne (AASHTO)

Për të përdorur metodën AASHTO, llogaritja e shtresave u bë për një frekuencë të kufizuar mjjetesh të rënda që përfshin kamiona me peshë totale deri 20 ton si dhe për një trafik me intensitet mesatar ditor prej rreth 60 autovetura në 24 ore. Është e natyrshme që për efekte të llogaritjes së shtresave, autoveturat nuk kanë ndonjë ndikim të madh.

Metoda e konsideron shtresën e rrugës si një mbulesë fleksibël dhe vlerësimi i trafikut bëhet sipas metodës duke bërë vrojtime në terren në ditë dhe intervale të ndryshme gjatë 24 orëve të qarkullimit. Meqënëse nuk ka ndonjë vërtetim të tillë, pasi edhe afati kohor i përgatitjes së projektit nuk e mundëson një gjë të tillë, janë marrë vlera të përafërta duke pranuar në rrugët e brëndëshme të bllokut a-priori një intensitet prej rreth 10 automjete të rënda e të mesme për 24 orë dhe 50 autovetura në 24 orë. Faktori i ekuivalencës (EF) llogaritet me formulën $N_{aksiale}/8160$. Më tej përcaktohet mesatarja vjetore e trafikut ditor (AADT) që do të përdoret për përcaktimin e vlerës së trafikut llogaritës për projektimin për periudhën 20-vjeçare të shërbimit në formën e numrit akumulativ në milionë akse standard ekuivalent (ESA Equivalent Standart Axes) të nevojshme për projektimin e shtresave rrugore. Indeksi i nivelit të shërbimit (PSI) përcaktohet midis vlerave 0-5 (5 për rrugë shumë të mirë) si aftësi për t'i shërbyer tipit të trafikut që do të përdori rrugën.

Çdo shtresë është konvertuar në një strukturë shtrese fleksibël nëpërmjet një koeficienti AASHTO të strukturës së shtresës nëpërmjet numrit të strukturës (SN) dhe që shpreh masën e aftësisë relative të materialit të shtresës.

Më tej llogaritja e trashësisë së shtresës bëhet nëpërmjet monogramave duke përdorur numrin e automjeteve që qarkullojnë në 24 orë, raportin mbajtës kalifornian CBR dhe koeficientin e presionit në rrugë M (në MPa) duke gjetur koeficientin I në bazë të të cilit, mbasi kemi përcaktuar shtresat e sipërme të asfaltbetonit 3 cm, binder 4 cm, stabilizant 10 cm, cakull gurore 15 cm.

Llogaritja e shtresave rrugore për segmente të ndryshme të rrugëve

Nga analiza e bërë për rezultatet e nxjerra nga llogaritjet analitike të shtresave rrugore mund të themi sa më poshtë:

Meqënëse parametrat e kërkuar nga metoda e llogaritjes së shtresave rrugore sipas standartit AASHTO nuk janë të saktë pasi vlerat e tyre janë të pabazuara në matje ditore të trafikut, mendojmë se llogaritjet sipas institutit DORNI (metoda ruse) japin një vlerë më të besueshme të trashësisë së shtresave pasi llogaritjet mbështeten në koeficientët e deformacionit të shtresave që janë parametra të matshëm eksperimentalisht dhe, si të tillë, më të besueshëm.

Nga ana tjetër, meqënëse efektin më të madh në deformimin e shtresave rrugore e japin ngarkesat statike me veprim të gjatë, siç është për shëmbull pesha e automjeteve të pastrimit të qytetit që mund të stacionohen për një kohë jo shumë të shkurtër gjatë operacioneve të punës, kemi

pranuar përfundimisht si më të besueshme trashësitë s shtresave të llogaritur me metodën statike si më poshtë:

Asfaltobeton	3 cm;
Binder	4 cm;
Stabilizant	10 cm;
Çakull makinerie	15cm

Llogaritja hidraulike për sistemin e kanalizimeve

Të përgjithëshme

Gjatë llogaritjes së rrjetit të kanalizimeve është patur parasysh rritja e intensitetit të ndertimeve ne zonë (pjesa e ndërtimeve sherbimesh) ashtu edhe zhvillimi i ndertimeve ne zonë (ose “betonimi” i zonës) që sjellin si rezultat rritjen e sasive të ujrave të zeza dhe ujrave të shiut respektivisht për shkak të rritjes së konsumit të ujit ne zone dhe rritjes së koeficientit të rrjedhës së ujrave të shiut.

Në zonat ku ka kanalizime ekzistuese ndodh mbingarkesa e kanalizimeve si rezultat i rritjes së prurjeve të ujit dhe ne zonat pa kanalizime ndodh mbytja e sipërfaqeve duke shkaktuar probleme serioze sanitare si dhe dëmtime masive të trupit të rrugës.

Të nisur nga sa më sipër gjatë hartimit të projekt-zbatimit është marrë parasysh perspektiva 25 vjeçare e rritjes së popullsisë si dhe rritja e koeficientit të rrjedhës së ujrave të shiut për shkak të asfaltimit dhe betonimit të sipërfaqeve të rrugë-trotuareve dhe të banesave të reja në zonë. Sistemi i largimit të ujrave të bardha dhe të zeza është parshikuar të jetë i ndare.

Llogaritjet hidraulike për sistemin e kanalizimit të ujrave të zeza

Per sasite e ujrave të zeza që derdhen ne sistemin e kanalizimeve janë përdorur të dhënat e rekomanduara ne studimin për kanalizimet janë $Q_{mes,dit}=150$ l/dite/banore dhe $Q_{max,or}= 300$ l/dite/banore

Per sasite e ujrave të shiut janë përdorur të dhënat e Institutit Hidrometeorologjik për reshjet maksimale me siguri dhe kohëzgjatje të percaktuar nga studimi hidrologjik. Llogaritjet hidraulike janë bërë duke përdorur formulat bazë të hidraulikës për rrjedhjen pa presion në tubacione betoni me formë seksioni rrethore dhe bazuar në pjerrësitë e tubacioneve është provuar se tubacionet prej materiali betoni kanë diametrat me rezervë të mjaftueshme për përcjelljen e ujrave të shiut si dhe të ujrave të zeza që grumbullohen në secilin tubacion të rrjetit mikës të kanalizimeve.

Kështu, bazuar edhe në diametrin minimal të tubacioneve të kanalizimeve për zona banimi është pranuar si diametër pune për tubacionet prej HDPE të kanalizimeve të ujrave të shiut diametri 250 – 315mm.

Materialet që do të përdoren në projekt

Si material kryesor për kanalizimin është parashikuar të jete përdorimi i tubave prej polietileni të brinjëzuar për ngarkese të rëndë (SN8), pusetat dhe nënobjektet e tjera do të jenë me material polietileni duke kufizuar në maksimum përdorimin e materialit të tullës në sistemin e kanalizimeve që ka rezultuar me probleme.

Për efekt preventivi për fazën e projekt zbatimit do të paraqitet edhe varianti i kanalizimeve me tubo betoni. Materialet e tjera të ndërtimit që do të përdoren (siç janë ato prej betoni për rrugët apo për bazamentet e shtyllave të ndriçimit, etj.) do të jenë në përputhje me standartin shqiptar si dhe me specifikimet teknike të cilat do të aprovohen nga Bashkia Shkoder gjatë fazave të miratimit të projektit.

Standarti i pranuar për projektin e rehabilitimit të infrastrukturës së bulevardit do të jetë standarti shqiptar që është në fuqi. Në këtë kontekst projektuesi do të realizojë projektin në përputhje me kushtet teknike dhe normat e projektimit shqiptar për secilin komponent të projektit.

PROBLEMET QË ZGJIDHEN

Për rrugët automobilistike

Rruga automobilistike është me gjeresi varjabel përgjithsisht pa trotuar. Sensi i levizjes është me një drejtim dhe do të bëhet kembimi i mjeteve në segmentet e gjera

Kanalizimet e ujrave të zeza

Rrjeti ekzistues i kanalizimeve është i amortizuar dhe do të ndërtohen linja të reja me të gjithë elementet puseta betoni dhe kapak çeliku.

“INVICTUS” sh.p.k.

Ing. Andrin KËRPAÇI

Ing. Laerta LIKO

GUSHT 2018

SPECIFIKIME TEKNIKE

OBJEKTI: "RIKONSTRUKSION RRUGA "HAFIZ ALI ULQINAKU", BASHKIA SHKODËR

SPECIFIKIMET TEKNIKE

KAPITULLI 1

TE PERGJITHSHME

TABELA E PERMBAJTJES

- 1.1 TE PERGJITHESHME
- 1.2 ZEVENDESIMET
- 1.3 DOKUMENTAT DHE VIZATIMET
- 1.4 KOSTOT PER MOBILIZIM DHE PUNIME TE PERKOHSHME
- 1.5 HYRJA NE SHESH
- 1.6 FURNIZIMI ME UJE
- 1.7 FURNIZIMI ME ENERGJI ELEKTRIKE
- 1.8 PIKETIMI I PUNIMEVE
- 1.9 FOTOGRAFIMI I SHESHIT
- 1.10 BASHKEPUNIMI NE SHESH
- 1.11 MBROJTJA E PUNIMEVE DHE E PUBLIKUT
- 1.12 MBROJTJA E AMBJENTIT
- 1.13 TRANSPORTI DHE MAGAZINIMI I MATERJALEVE
- 1.14 SHESHI PER MAGAZINAT DHE ZYRAT
- 1.15 DOKUMENTIMI I VIZATIMEVE
- 1.16 PASTRIMI PERFUNDIMTAR I SHESHIT
- 1.17 PROVAT

1.1 Te pergjithshme

Paragrafet ne kete kapitull jane plotesuese te detajeve te dhena ne Kushtet e Kontrates.

1.2 Zevendesimet

Zevendesimi i materjaleve te specifikuara ne Dokumentin e Kontrates do te behen vetem me aprovimin e Mbikqyresit te Punimeve ne se materjali i propozuar per tu zevendesuar eshte i njejte ose me i mire se materjalet e specifikuara ; ose ne se materjalet e specifikuara nuk mund te sillen ne sheshin e ndertimit ne kohe per te perfunduar punimet e Kontrates per shkak te kushteve jashte kontrollit te Sipermarresit. Qe kjo te merret ne konsiderate, kerkesa per zevendesim do te shoqerohet me nje dokument deshmi te cilesise, ne formen e kuotimit te certifikuar dhe te dates se garancise te dorezimit nga furnizuesit e te dy materjaleve, si te materialit te specifikuar ashtu edhe te atij qe propozohet te ndryshohet.

1.3 Dokumentat dhe vizatimet

Sipermarresi do te verifikojte te gjitha dimensionet, sasite dhe detajet te treguar ne Vizatimet, Grafiket,ose te dhena te tjera dhe Punedhenesi nuk do te mbaje pergjegjesi per ndonje mangesi ose mosperputhje te gjetur ne to. Mos zbulimi ose korrigjimi i gabimeve ose mosperputhjeve nuk do ta lehtesoje Sipermarresin nga pergjegjesia per pune te pakenaqeshme .Sipermarresi do te marre persiper te gjithe pergjegjesine ne berjen e llogaritjeve te madhesive , llojeve dhe sasive te materjaleve dhe pajisjeve te perfshira ne punen qe duhet bere sipas Kontrates. Ai nuk do te lejohet te kete avantazhe nga ndonje gabim ose mosperputhje, ndersa nje udhezim i plote do te jepet nga Punedhenesi ne se gabime te tilla ose mosperputhje do te zbulohen.

1.4 Kostot e Sipermarresit per mobilizim dhe punime te perkoheshme

Do te kihet parasysh qe Sipermarresit nuk do ti behet asnje pagese mbi cmimet njesi te kuotuar per kostot e mobilizimit d.m.th. per sigurimin e transportit, drite, energjine, veglat dhe pajisjet,ose per furnizimin e godines dhe mirembajtjen e impjanteve te ndertimit, rrugeve te hyrjes, te komoditeteve sanitare heqje e mbeturinave, punen, furnizimin me uje, mbrojtjen kundra zjarrit, bangot e punes, rojet, rrjetin telefonik si dhe struktura te tjera te perkoheshme, pajisje dhe materjale, ose per kujdesin mjeksor dhe mbrojtjen e shendetit, ose per patrullat dhe rojet, ose per ndonje sherbim tjetër, lehtesi, gjera, ose materjale te nevojshme ose qe kerkohen per zbatimin e punimeve ne perputhje me ate qe eshte parashikuar ne Kontrate.

1.5 Hyrja ne sheshin e ndertimit

Sipermarresi duhet te organizoje punen per ndertimin, mirembajen dhe me pas te spostoje dhe ta rivendose cdo rruge hyrje qe do te duhet ne lidhje me zbatimin e punimeve. Çvendosja do te perfshije pershtatjen e zones me cdo rruge hyrje dhe se paku me shkalle sigurie, qendrushmerie dhe te kullimit te ujrave siperfaqesore te njejte me ate qe ekzistonte perpara se Sipermarresi te hynte ne Shesh.

1.6 Furnizimi me uje

Uji, qe nevojitet per zbatimin e punimeve, do te merret nga rrjeti kryesor nepermjet nje matesi ne piken me te afert te mundeshme. Sipermarresi do te shtrije rrjetin e vet te perkoheshem te tubacioneve. Lidhjet me rrjetin kryesor dhe kostot per kete do te paguhen nga Sipermarresi. Ne rastet kur nuk ka mundesi lidhje me rrjetin kryesor, Sipermarresi duhet te beje vete perpjekjet per furnizimin me uje higjenikisht te paster dhe te pijshem per punetoret dhe punimet.

1.7 Furnizimi me energji elektrike

Sipermarresi do te beje perpjekjet dhe me shpenzimet e tij per furnizimin me energji elektrike ne kantjer, si me kontraktim me KESH – in, kur lidhjet me rrjetin kryesor lokal jane te mundura, ose duke parashikuar gjeneratorin e vet per te permbushur kerkesat.

1.8 Piketimi i punimeve

Sipermarresi, me shpenzimet e tij duhet te beje ndertimin e modinave dhe te piketave sic kerkohet, ne perputhje me informacionin baze te Punedhesisit, dhe do te jete pergjegjesi i vetem per perpikmerine.

Sipermarresi do te jete pergjegjes per te kontrolluar dhe verifikuar informacionin baze qe i eshte dhene dhe ne asnje menyre nuk do te lehtesohet nga pergjegjesia e tij ne se nje informacion i tille eshte i manget, jo autentik ose jo korrekt. Ai nderkohe do te jete subjekti qe do te kontrollohet dhe rishikohet nga Punedhenesi, dhe ne asnje rast nuk i jepet e drejta te beje ndryshime ne vizatimet e kontrates , per asnje lloj kompensimi per korrigjimet e gabimeve ose te mangesive. Sipermarresi do te furnizojte dhe mirembaje me shpenzimet e tij, rrethimin dhe materiale te tjera te tilla dhe te jape asistenca nepermjet nje stafi te kualifikuar sic mund te kerkohet nga Punedhenesi per kontrollin e modinave dhe piketave.

Sipermarresi do te ruaje te gjitha pikat e akseve, modinat, shenjat e kuotave, te bera ose te vendosura gjate punes, te mbuloje koston e rivendosjes se tyre nese ato demtohen dhe te mbuloje te gjitha shpenzimet per ndreqjen e punes se bere jo mire per shkak te mosmirembajtjes ose mbrojtjes ose spostimit pa autorizim te ketyre pikave te vendosura, modinave dhe piketave.

Perpara cdo aktiviteti ndertimor, Sipermarresi do te kete linjat e furnizimit me uje dhe energji elektrike te vendosura ne terren, te drejten e kalimit te qarte dhe te sheshuar, gati per fillimin e punimeve. Çdo pune e bere jasht akseve, kuotave dhe kufijve te treguara ne vizatime ose te mosmiratuara nga Punedhenesi nuk do te paguhet, dhe Sipermarresi do te mbuloje me shpenzimet e tij germimet shtese gjithmone nen drejtimin e Mbikqyresit te Punimeve.

1.9 Fotografite e sheshit te ndertimit

Sipermarresi duhet te beje forografi me ngjyra sips udhezimeve te Mbikqyresit te Punimeve ne vendet e punes per te demonstruar kushtet e sheshit perpara fillimit , progresin gjate punes se ndertimit dhe mbas perfundimit te punimeve. Nuk do te behen pagesa per fotografimin e kantierit te punimeve pasi keto shpenzime jane parashikuar te mbulohen nen koston administartive te Sipermarresit.

1.10 Bashkepunimi ne zone

Ndertimi do te behet ne zona te kufizuara. Sipermarresi duhet te kete vecanerisht kujdes ne:

- a) nevojen per te mirembajtur sherbimet ekzistuese dhe mundesite e kalimit per banoret dhe tregetaret qe jane ne zone, gjate periudhes se ndertimit.
- b) prezencen e mundeshme te kontraktoreve te tjere ne zone me te cilet do te koordinohet puna

E gjithë puna, do te behet ne nje menyre te tille, qe te lejoje hyrjen dhe perballimin e te gjithë pajisjeve te mundeshme per ndonje Kontraktor tjetër dhe punetoreve te tij, stafin e Punedhesisit si edhe te cdo punojnjesi qe mund te punesohet ne zbatim dhe/ose punimet ne zone ose prane saj per cdo objekt qe ka lidhje me Kontraten ose cdo gje tjetër.

Ne pregatitjen e programit te tij te punes, Sipermarresi gjate gjithë kohes do te beje llogari te plote dhe do te koeperoje me programin e punes se Kontraktoreve te tjere, ne menyre qe te shkaktoje nje minimum interference me ta dhe me publikun.

1.11 Mbrojtja e punes dhe e publikut

Sipermarresi do te mare masa paraprake per mbrojtjen e punetoreve te punesuar dhe te jetes publike si edhe te pasurive ne dhe rreth sheshit te ndertimit. Masat e sigurimit paraprak te ligjeve te aplikushme, kodeve te ndertesave dhe te ndertimit do te respektohen. Makinerite, pajisjet dhe cdo rrezik do te kqyren ose eliminohen ne perputhje me masat paraprake te sigurimit.

Gjate zbatimit te punimeve Sipermarresi, me shpenzimet e veta, duhet te vendosi dhe te mirembaje gjate nates pengesa te tilla dhe drita te cilat do te parandalojne ne menyre efektive aksidentet. Sipermarresi duhet te siguroje pengesa te pershtateshme, shenja me drite te kuqe “rrezik” ose “kujdes” dhe vrojtues ne te gjitha vendet ku punimet mund te shkaktojne rregullime te trafikut normal ose qe perbejne ne ndonje menyre rrezik per publikun..2

1.12 Mbrojtja e ambientit

Sipermarresi, me shpenzimet e veta, duhet te ndermarre te gjithë veprimet e mundshme per te siguruar qe ambienti lokal i sheshit te ruhet dhe qe vijat e ujit, toka dhe ajri (duke perfshire edhe zhurmat) te jene te pastra nga ndotja per shkak te punimeve te kryera . Mos plotesimi i kesaj klauzole ne baze te evidentimit nga Mbikqyresi i Punimeve, mund te coje ne nderprerjen e kontrates.

1.13 Transporti dhe magazinimi i materialeve

Transporti i cdo materiali nga Sipermarresi do te behet me makina te pershtateshme te cilat kur ngarkohen nuk shkaktojne derdhje dhe e gjithë ngarkesa te jete e siguruar. .Ndonje makine qe nuk ploteson kete kerkese ose ndonje nga rregullat ose ligjet e qarkullimit do te hiqet nga kantjeri. Te gjitha materialet qe sillen nga Sipermarresi, duhet te stivohen ose te magazinohen ne menyre te pershtateshme per ti mbrojtur nga rreshqitjet, demtimet, thyerjet, vjedhjet dhe ne dispozicion, per tu kontrolluar nga Mbikqyresi i Punimeve ne çdo kohe.

1.14 Sheshi per magazinim

Sipermarresi duhet te beje me shpenzimet e tij martjen me qira ose blerjen e nje terreni te mjaftueshem per ngritjen e magazinave me shpenzimet e tij.

1.15 Kopjimi i vizatimeve (Vizatimet sic eshte zbatuar)

Sipermarresi duhet te pergatise vizatimet per te gjitha punimet “sic jane faktikisht zbatuar” ne terren. Vizatimet do te behen ne nje standart te ngjashem me ate te vizatimeve te Kontrates.

Gjate zbatimit te punimeve ne kantier, Sipermarresi do te ruaje te gjithë informacionin e nevojshem per pergatitjen e “Vizatimeve sic eshte zbatuar”. Do te shenoje ne menyre te qarte vizatimet dhe te gjitha dokumentat e tjera te cilat mbulojne punen e vazhdueshme te perfunduar, material i cili do te jete i disponueshem ne cdo kohe gjate zbatimit per Menaxherin e Projektit. Keto vizatime do te azhurnohen ne menyre te vazhdueshme dhe do t’i dorezohen Mbikqyresit te Punimeve çdo muaj per aprovim, pasi Punimet te kene perfunduar, sebashku me kopjen perfundimtare. Materiali mujor do te dorezohet ne kopje leter.

Vizatimet e riprodhuara do te perfshijne pozicionin dhe shtrirjen e te gjithë konstruksioneve mbajtese te lena gjate germimeve dhe vendosjen ekzakte te te gjitha sherbimeve qe jane ndeshur gjate ndertimit. Sipermarresi gjithashtu duhet te pergatise seksionet e profilit gjatesor te rishikuar, pajisur me shenimet qe tregojne shtresat e tokes qe hasen gjate te gjitha punimeve te germimit.

Si perfundim, kopjet e riprodhuara te Vizatimeve “ sic eshte zbatuar” do t’i dorezohen Mbikqyresit te Punimeve per aprovim. Vizatimet “sic eshte zbatuar” ,te aprovuara, do te behen prone e Punedhensit.

Nuk do te behen pagesa per berjen e Vizatimeve “sic eshte zbatuar” dhe Manualeve, pasi kosto e tyre eshte parashikuar te mbulohet nga shpenzimet administrative te Sipermarresit.

1.16 Pastrimi perfundimtar i zones

Ne perfundim te punes, sa here qe eshte e aplikueshme Sipermarresi, me shpenzimet e tij, duhet te pastroje dhe te heqe nga sheshi te gjitha impiantet ndertimore, materialet qe kane tepruar, mbeturinat, skelerite dhe ndertimet e perkoheshme te cdo lloji dhe te lere sheshin e tere dhe veprat te pastra dhe ne kondita te pranueshme. Pagesa perfundimtare e Kontrates do te mbahet deri sa kjo te realizohet dhe pasi te jepet miratimi nga Mbikqyresi i Punimeve.

1.17 Provat

Ky seksion perfqeson procedurat e kryerjes se provave per materialjet me qellim qe te siguroje dhe perputhje me kerkesat e Specifikimeve.

Tipi dhe Zbatimi i Provave

Do te kryhen provat e meposhtme:

- Permbajtja e Ujit
- Densiteti Specifik
- Indeksi i Plasticitetit
- Densiteti ne gjendje te thate (Metoda e Zevendesimit me Rere)
- Shperndarja Sipas Madhesis se Grimcave (Sitja)
- Proktori i Modifikuar dhe Normal
- CBR (California Bearing Ratio)
- Provat e Bitumit
- Provat e Betonit (Thermimi i Kampioneve)

Standartet per Kryerjen e Provave

Te gjitha provat do te behen ne perputhje me metodat standarte shqiptare ose me te tjera nderkombetare te aprovuara.

Marrja e Kampioneve edhe Numri i Provave

Metoda e marrjes se kampioneve do te jete sic eshte specifikuar ne metodat e aplikueshme te marrjes se kampioneve dhe te kryerjes se provave ose sic udhezohet nga Mbikqyresit te Punimeve.

Frekuenca e kryerjes se provave do te perputhet me treguesit ne Specifikimet Teknike dhe nese nuk gjendet atje, do te jepet nga Mbikqyresit te Punimeve. Marrja e ndonje kampioni shtese mund te udhezohet nga Mbikqyresit te Punimeve.

Ene te tilla si canta, kova e te tjera, do te jepen nga Sipermarresi. Marrja e kampioneve do te kryhet nga Sipermarresi ne vendet dhe periudhat qe udhezon Mbikqyresit te Punimeve. Marrja, transportimi e sjellja e tyre ne laborator do te behet nga Sipermarresi.

Nderprerja e Punimeve

Nderprerja e punimeve per arsye te marrjes se kampioneve do te perfshihet ne grafikun e punimeve te Sipermarresit.

Nuk do te pranohet asnje ankese nga nderprerja e punimeve, per shkak te marrjes se kampioneve.

Provat ne laborator, do te behen ne nje kohe te pershtatshme me metoden e pershkruar.

Provat e Kryera nga Sipermarresi

Per arsye krahasimi, Sipermarresi eshte i lire te kryeje vete ndonje prej provave. Rezultatet e provave te tilla do te pranohen vetem kur te kryhen ne nje laborator te aprovuar me shkrim nga Mbikqyresit te Punimeve. Te gjitha shpenzimet e provave te tilla pavaresisht se nga vijne rezultatet do te mbulohen nga Sipermarresi.

SPECIFIKIMET TEKNIKE

KAPITULLI 2

GERMIMET

TABELA E PERMBAJTJES

- 2.1 QELLIMI
- 2.2 PERCAKTIMET
- 2.3 GERMIMI
- 2.4 TRAJTIMI/NGJESHJA E ZONAVE TE GERMUARA
- 2.5 PASTRIMI I SHESHIT
- 2.6 GERMIMI PER STRUKTURA
- 2.7 GERMIMI I KANALEVE PER TUBACIONET
- 2.8 PERDORIMI I MATERIALEVE TE GERMIMIT
- 2.9 NDERTIMI I MBUSHJEVE
- 2.10 RIMBUSHJA E THEMELEVE
- 2.11 PERFORCIMI I NDERTESAVE
- 2.12 PERFARCIMI DHE VESHJA E GERMIMEVE
- 2.13 MIREMBAJTJA E GERMIMEVE
- 2.14 LARGIMI I UJRAVE NGA PUNIMET E GERMIMIT
- 2.15 PERFORCIMI DHE MBULIMI NE VEND
- 2.16 MBROJTJA E SHERBIMEVE EKZISTUESE
- 2.17 HEQJA E MAETRIALEVE TE TEPERTA NGA GERMIMI
- 2.18 PERSHKRIMI I ÇMIMIT NJESI PER GERMIMET
- 2.19 MATJET

2.1 Qellimi

Ky seksion permban percaktimet e pergjithshme dhe kerkesat per punimet e germimeve ne toke (ne vellim dhe/ose me shtresa) dhe germimet per struktura ne kanale, perfshire germim nen uje. Me tej ajo mbulon te gjitha punimet qe lidhen me konstruksionin e prerjeve, largimin e materialeve te papershtatshme ne hedhurina, dhe rifiniturat e shpatit te prerjes.

2.2 Percaktimet

Percaktimet e meposhtme duhet te aplikohen:

DHERAT

Germimi ne dhera duhet te aplikohet ne te gjitha materialet qe mund te germohen si me krahe (perfshi me kazma) ashtu dhe me makineri.

MATERIALE TE PERSHTATSHME

Materialet e pershtatshme do te perfshijne te gjitha materialet qe jane te pranueshme ne perputhje me kontraten e perdorimit ne punimet dhe qe jane ne gjendje te ngjeshen ne je menyre te specifikuar per te formuar mbushje ose trase.

2.3 Germimi

- a) Germimi duhet te kryhet ne perputhje me nivelet dhe vijen e prerjeve sic tregohet ne Vizatime. Cdo thellesi me e madhe e germuar nen nivelin e formacionit, brenda tolerances se lejuar, duhet te behet mire me mbushje me materiale te pranueshme me karakteristika te ngjashme nga Sipermarresi me shpenzimet e tij.
- b) Kujdes i vecante duhet te ushtrohet kur germohen prerje per te mos hequr material pertej vijes se specifikuar te prerjes dhe me pas duke shkaktuar rrezikshmeri per qendrueshmerine strukturore te pjerresise ose duke shkaktuar erozion ose disintegrimin e pjeseve te ngjeshura.
- c) Permasat e prerjeve duhet te jene ne perputhje me detajet e seksione terthore tip sic tregohen ne Vizatime.

2.4 Trajtimi/Ngjeshja e Zonave te Germuara

- a) Zonat dhe pjerresite e prerjeve duhet te jene konform me Vizatimet dhe duhet te rregullohen sipas nje vije te paster te standartit, per nje tip te dhene materiali.
- b) Te gjitha zonat horizontale te germuara, duhet te ngjeshen me nje minimum dendesie te thate prej 95% per dhera te shkrifet dhe 90% per dhera te lidhur.

2.5 Pastrimi i sheshit

Te gjitha sheshet ku do te germohet, do te pastrohen nga te gjitha shkurret, bimet, ferrat, rrenjet e medha, plehrat dhe materiale te tjera siperfaqesore. Te gjitha keto materiale do te spostohen dhe largohen ne menyre qe te jete e pelqyeshme per Punedhenesin. Te gjitha pemet dhe shkurret qe jane pecaktuar nga Punedhenesi qe do te ngelen do te mbrohen dhe ruhen ne menyren e aprovuar.

Te gjitha strukturat ekzistuese te identifikuara per tu prishur do te largohen sipas udhezimeve te Mbikqyresit te Punimeve. Kjo do te perfshije dhe spostimin e themeleve te ndertimeve qe mund te ndeshen.

Sipermarresi do te marre te gjitha masat e nevojeshme per mbrojtjen e vijave ekzistuese te ujit, rrethimeve dhe sherbimeve qe do te mbeten ne sheshin e ndertimit. Kosto e pastrimit te kantierit eshte e detyrueshme te paguhet brenda cmimit njesi per punimet e germimit.

2.6 Germimi per Strukturat

Germimi per strukturat duhet te jete ne perputhje me Vizatimet. Anet duhen mbeshtetur ne menyre te pershtatshme gjate gjithë kohes. Nje alternative eshte qe ato mund te ngjeshen ne menyre te pershtatshme.

Germimet duhet te mbahen te pastra nga uji. Tabani i te gjithë germimeve duhet te nivelohet me kujdes. Cdo pjese me material te bute ose mbeturina shkembj ne taban duhet te hiqet dhe kaviteti qe rezulton te mbusht me beton.

2.7 Germimi i kanaleve per tubacionet

Kanalet do te germohen ne dimensionet dhe nivelin e e treguar ne vizatime dhe /ose ne perputhje me instruksionet me shkrim te Mbikqyresit te Punimeve. Zeri I treguar ne tabelen e Volumeve (Preventiv) lidhur me germimet ,sic eshte largimi I materialit te germuar, etj. do te perfshije cdo lloj kategorie dheu, nese nuk do te jete specifikuar ndryshe. Germimi me krahe eshte gjithashtu i nevojshem ne afersi te intersektiveve te infrastrukturave te tjera per te parandaluar demtimin e tyre. Me perjashtim te vendeve te permendura me sipër , mund te perdoren makinerite.

Ne se nuk urdherohet apo lejohet ndryshe nga Mbikqyresi i Punimeve nuk duhet te hapen me shume se 30 metra kanal perpara perfundimit te shtrirjes se tubacionit ne kete pjese kanali. Gjeresia dhe thellesia e kanaleve te tubacioneve do te jete sic eshte percaktuar ne vizatimet e kontrates ose sic do te udhezohet nga Mbikqyresi i Punimeve .

Thellimet per pjeset lidhese do te germohen me dore mbasi fundi i kanalit te jete niveluar. Pervet se kur kerkohet ndryshe, kanalet per tubacionet do te germohen nen nivelit te pjese se poshteme te tubacionit sic tregohet ne vizatime, per te bere te mundur realizimin e shtratit te tubacioneve me material te granular.

2.8 Perdorimi i Materialeve te germimit

Te gjitha materialet e pershtatshme dhe te aprovuara te germimit duhet, persa kohe qe ato jane praktike, te perdoren ne ndertim per mbushje dhe punime rruge.

2.9 Ndertimi i mbushjeve

Tabani i dheut i shtresave rrugore eshte pjese e trupit te dheut ku shperndahen nderjet e shkaktuara nga ngarkesat e levizshme te automjeteve dhe e vete konstruksionit. Ky taban mund te jete ne mbushje ose ne germim. Si ne njerin rast edhe ne tjetrin eshte e nevojshme qe te sigurohet nje taban, qe te jete ne gjendje te transmetoje me poshte, ne trupin e dheut ngarkesat qe vijne nga shtresat rrugore, pa pesuar deformime mbetese.

Mbushja gjithandej duhet te kete nje densitet qe i referuar standartit AASHTO te modifikuar te jete max. ne te thate jo me pak se 90%, per shtresat e poshtme te ngjeshura dhe 95%, per shtresen e sipërme 30cm (subgrade).

Çdo shtrese duhet te ngjishet me lageshtine optimale duke shtuar ose thare shtresen sipas rastit dhe kerkeses se llojit te materialit qe do te perdoret ne mbushje te rruges.

Çdo shtrese e re ne mbushje duhet te miratohet nga Mbikqyresit te Punimeve, pasi te jete siguruar se shtresa paraardhese nuk ka deformacione ose probleme me burime uji apo lageshtire te tepert.

Zgjedhja e pajisjeve te ngjeshjes eshte e lire te behet nga Sipermarresi, mjafton qe pajisjet ngjeshese te sigurojne energjine e nevojshme dhe te arrijne densitetet e kerkuara ne ngjeshje per shtresen ne ndertim.

2.10 Rimbushja e Themeleve

Te gjitha mbushjet per kete qellim duhet te behen me materiale te pershtatshme dhe te ngjeshen, vetem nese tregohet ndryshe ne Vizatime ose urdherohet nga Mbikqyresit te Punimeve.

2.11 Perforcimi i ndertesave

Si pjese e punes ne zerat e germimit Sipermarresi ,me shpenzimet e veta, do te perforcoje te gjithë ndertimet, muret si edhe strukturat e tjera qendrushmeria e te cilave duhet te garantoje mosrrezikimin gjate zbatimit te punimeve dhe do te jete teresisht pergjegjies per te gjithë demtimet e personave ose te pasurive qe do te rezultojne nga aksidentet e ndonje prej ketyre ndertimeve, mureve ose strukturave te tjera.

Neqofte ndonje nga keto pasuri, struktura, instalime ose sherbime do te rrezikohen ose demtohen si rezultat i veprimeve te Sipermarresit, ai menjehere duhet te raportoje per keto rreziqe ose demtime Menaxherin e Projektit si dhe autoritetet qe kane lidhje me te dhe menjehere te mare masa per ndreqjen gjithmone sipas pelqimit te Mbikqyresit te Punimeve ose te autoriteteve perkatese.

2.12 Perforcimi dhe veshja e germimeve

Nese germimi i zakonshem nuk eshte i mundur apo i keshillueshem, gjate germimeve duhet te vendosen struktura mbajtese per te parandaluar demtimet dhe vonesat ne pune si edhe per te krijuar kushte te sigurta pune. Sipermarresi do te furnizojte dhe vendose te gjitha strukturat mbajtese, mbulese, trare dhe mjete te ngjashme te nevojeshme per sigurimin e punes, te publikut ne pergjithesi dhe te pasurive qe jane prane. Strukturat mbrojtese do te hiqen sipas avancimit te punes dhe ne menyre te tille qe te parandalojne demtimin e punes se perfunduar si edhe te strukturave e pasurive qe jane prane. Sapo keto te hiqen te gjitha boshlleqet qe mbeten nga heqja e ketyre strukturave duhet te mbushen me kujdes dhe me material te zgjedhur dhe te ngjeshur. Sipermarresi do te jet krejtesisht pergjegjes per sigurimin e punes ne vazhdim, te punes se perfunduar, te punetoreve, te publikut dhe te pasurive qe jane prane. Kosto e perforcimit dhe veshjes se germimeve eshte perfshire ne cmimin njesi per germimet.

2.13 Mirembajtja e germimeve

Te gjitha germimet do te mirembahen sic duhet nderkohe qe ato jane te hapura dhe te ekspozuara, si gjate dites ashtu edhe gjate nates. Pengesa te mjaftueshme, drita paralajmeruese, shenja, si edhe mjete te ngjashme do te sigurohen nga Sipermarresi. Sipermarresi do te jete pergjegjes per ndonje demtim personi ose pronesia per shkak te neglizhences se tij.

2.14 Largimi i ujerave nga punimet e germimit

Si pjese e punes ne zerat e germimit dhe jo me kosto plus per Punedhenesin, Sipermarresi do te ndertoje te gjitha drenazhimet dhe do te realizojte kullimin me kanale kulluese ,me pompim ose me kova si edhe te gjithe punet e tjera te nevojeshme per te mbajtur pjesen e germuar te paster nga ujerat e zeza dhe nga ujera te jashme gjate avancimit te punes dhe deri sa puna e perfunduar te jete e siguruar nga demtimet. Sipermarresi duhet te siguroje te gjitha pajisjet e pompimit per punimet e tharjes se ujit si edhe personelin operativ, energjine e te tjera, dhe te gjitha keto pa kosto shtese per Punedhenesin. I gjithu uji i pompuar ose i drenazhuar nga vepra duhet te hiqet ne nje menyre te aprovueshme prej Mbikqyresit te Punimeve. Duhet te meren masa paraprake te nevojeshme kunder permbytjeve .

2.15 Perforcimi dhe mbulimi ne vend

Punedhenesi mund te urdheroje me shkrim qe ndonje ose te gjitha perforcimet dhe strukturat mbajtese te lihen ne vend me qellim te masave paraprake per mbrojtjen nga demtimet te strukturave, te pronesive te tjera ose personave, nese keto struktura mbajtese jane shenuar ne vizatime ose te vendosura sipas udhezimeve, ose nga ndonje arsye tjeter. Nese lihen ne vend keto struktura mbrojtese do te priten ne lartesine sipas udhezimeve te Mbikqyresit te Punimeve. Strukturat mbajtese qe mbeten ne vend do te shtrengohen mire dhe do te paguhen sipas vlerave qe do te bihet dakort reciprokisht ndermjet Sipermarresit dhe Punedhenesit ose sipas cmimit ne Oferte nqs eshte dhene, ose nga nje urdher ndryshimi me shkrim.

2.16 Mbrojtja e sherbimeve ekzistuese

Pusetat do te jene betoni me dimensione sipas vivatimeve. Menyra e realizimit te trupit te pusetes do jete sin e Kapitullin 5 (Betonet)

Kapaket prej gize te pusetave duhet te plotesojne keto kondita:

- Materiali gize e derdhur
- Permasat 300x300x20mm
- Forma drejtkendore
- I kompletuar me gjithë kornizen perkatese

9.4 Tubat Plastike

- Tubi fleksibel D=75mm dhe D=90mm duhet te plotesojne keto kushte:
 - Sigla FU 15
 - Normativa CEI EN 50086-1
 - Marka e cilesise IMQ ne cdo 3 ml
 - Materiali : polietilen. Tubat me 2 shtresa te densiteteve te ndryshme.
 - Fusha e perdorimit: per impiante nentokesore te rrjetave elektrike e telekomunikacionit.
 - Vendorsja : nen toke.

9.5 Tubat Metalike

- Tubat metalik duhet te jene pa tegel saldimi dhe te jene te zinguar, prodhime te sdandartizuara sipas normave europiane.
Gjatesia e tubave jo me e vogel se 6 m.

9.6 Ndricuesit

1. Ndricuesit Rrugore

- Prodhimi italian indy
- Fuqia e llampes : 250W Tipi I llampes : SAP

SPECIFIKIMET TEKNIKE

KAPITULLI 10

PUNIME PRISHJEJE DHE PASTRIMI

SEKSION 10

10.1. Punime prishjeje

10.2.1 Skeleritë

18.2.1 Supervizioni

18.2.2 Metoda dhe rradha e prishjes

18.2.3 Siguria në punë

PUNIME PRISHJEJE

Skeleritë

Çdo skeleri e kërkuar duhet skicuar në përshtatje me KTZ dhe STASH. Një skelator kompetent dhe me eksperiencë, duhet të marrë përsipër ngritjen e skelerive që duhet të çdo tipi. Kontraktori duhet të sigurojë, që të gjitha rregullimet e nevojshme, që i janë kërkuar skelatorit të sigurojnë stabilitetin gjatë kryerjes së punës. Kujdes duhet treguar që ngarkesa e copërave të mbledhura mbi një skeleri, të mos kalojë ngarkesën për të cilën ato janë projektuar. Duhet marrë të gjitha masat e nevojshme që të parandalohet rënia e materialeve nga platforma e skelës. Skeleritë duhen të jenë gjatë kohës së përdorimit të përshtatshme për qëllimin për të cilin do përdoren dhe duhet të jenë konform të gjitha kushteve teknike.

Në rastet e kryerjes së punimeve në anë të rrugës ku ka kalim si të kalimtarëve, ashtu edhe të makinave, duhet të merren masa që të bëhet një rrethim I objektit, si dhe veshja e të gjithë skelerisë me rrjete mbrojtëse për të eliminuar rënien e materialeve dhe duke përfshirë shenjat sinjalizuese sipas kushteve të sigurimit teknik.

Skeleri çeliku të tipit këmbalëc, konform KTZ dhe STASH, duke përfshirë ndihmën për transport, mirëmbajtje, montim, ankorim, çmontime etj. Në një lartësi mbi 12 m, elementët horizontalë duhet të kenë parmakë vertikalë, më lartësi min.15 cm si dhe mbrojtjen me rrjetë.

Skeleri çeliku në kornizë dhe e lidhur , konform KTZ dhe STASH, duke përfshirë ndihmën për transport, mirëmbajtje, montim, ankorim, çmontime etj. Në një lartësi mbi 12 m, elementët horizontalë duhet të kenë parmakë vertikalë, me lartësi min.15 cm si dhe mbrojtjen me rrjetë.

Supervizioni

Kontraktori duhet të ngarkojë një person kompetent dhe me eksperiencë, të trajnuar në llojin e punës për ngritjen e skelerive dhe të mbikëqyrë punën për ngritjen e skelave në kantier.

Metoda e prishjes

Puna për prishje do të fillojë vetëm pasi të jenë stakuar energjia elektrike dhe rrjete të tjera të instalimeve ekzistuese të objektit.

Metodat e prishjes së pjesshme, duhet të jenë të tilla që pjesa e strukturës që ka mbetur të sigurojë qëndrueshmërinë e ndërtesës dhe të pjesëve që mbeten.

Kur prishja e ndërtesës ose e elementeve të saj nuk mund të bëhet pa probleme e ndarë nga pjesa e strukturës do të përdoret një metodë pune e përshtatshme. Elementë çeliku dhe struktura betoni të forcuar do të ulen në tokë ose do të prihen për së gjati sipas gjerësisë dhe përmasave në menyre që te mos bien. Elementët e drurit mund të hidhen nga lart, vetëm kur ato nuk paraqesin rrezik për pjesën tjetër të strukturës. Kur prishen elementët, duhen marrë masa për të mos rrezikuar elementët e tjerë konstruktive mbajtës, si dhe mos dëmtohen elementët e tjerë.

Në përgjithësi, puna e shkatërrimit duhet të fillojë duke hequr sa më shumë ngarkesa të panevojshme, pa ndërhyrë në elementët bazë struktural. Punë të kujdesshme do të bëhen për të hequr ngarkesat kryesore nën kushtet më të vështira. Seksionet të tjera që do të prishen do të transportohen nga ashensorë, pastaj do të ndahen dhe do të ulen në tokë nën kontroll.

Siguria në punë

Kontraktori duhet të sigurohet se vendi dhe pajisjet janë :

Të një tipi dhe standarti të përshtatshëm duke iu referuar vendit dhe llojit të punës që do të kryhet

Të siguruar nga një teknik kompetent dhe me ekperiencë

Të ruajtura në kushte të mira pune gjatë përdorimit

Gjatë punës prishëse të gjithë punëtorët duhet të vishen me veshje të përshtatshme mbrojtëse ose mjete mbrojtëse si: helmata, syze, mbrojtëse, mbrojtëse veshësh, dhe bombola frymëmarrjeje.

Prishja e elementëve të godinës

Prishja e çatisë dhe e taracave

Shpërbërja e mbulesës së çatisë me tjegulla të tipit “Marsigliese” ose të tipit “Romana” (Vendi) dhe të armaturës përkatëse prej druri, duke përfshirë Trarët e mundshëm, dyshemenë ose paretet (ndërmjetëzat) me dërrasa, armaturën e madhe (e përbërë nga kapriatat, Trarët dhe pjesët e armaturës), pjesët intersektuese, kanalet e ulluqëve horizontale, ulluqët vertikalë dhe kapset përkatëse metalike që rezultojnë nga heqja brenda ambientit të kantierit, si dhe zgjedhjen, pastrimin dhe vënien mënjane të tjegullave “Marsegliese” që do të ripërdoren, si dhe çdo detyrim tjetër për t’i dhënë fund heqjes.

Shpërbërja e çatisë me tjegulla druri ose llamarinë të xinguar, me të njëjtat modalitete dhe të armaturës përkatëse prej druri, duke përfshirë trarët e mundshëm, dyshemenë ose paretet (ndërmjetëzat) me dërrasa, armaturën e madhe (e përbërë nga kapriatat, trarët dhe pjesët e armaturës), pjesët intersektuese, kanalet e ulluqëve horizontale, ulluqët vertikalë dhe kapset përkatëse metalike, kullezat e oxhakut, duke përfshirë skelën, spostimin e materialeve që rezultojnë nga heqja brenda ambientit të kantierit si dhe çdo detyrim tjetër për t’i dhënë fund heqjes.

Heqja e tavanit të çfarëdo natyre, duke përfshirë strukturën mbajtëse, suvanë dhe impiantin elektrik që mund të ekzistojë; duke përfshirë ndër të tjera skelën, spostimin e materialeve që rezultojnë nga heqja brenda ambientit të kantierit, si dhe çdo detyrim tjetër për t’i dhënë plotësisht fund heqjes së tavanit.

Prishje e Shtresës horizontale të hidro- izolimit të tarracës me zhvillime vertikale, edhe në praninë e oxhaqeve, e ndërtuar nga tre shtresa të mbivendosura letër katramaje, duke përfshirë heqjen e kapakëve të parapetit e të çdo pjese metalike dhe vënien mënjane e spostimin në kantier të materialeve që formohen, si dhe çdo detyrim tjetër për t’i dhënë fund plotësisht heqjes së tarracës.

Prishja e suvasë në sipërfaqet vertikale deri në një lartësi të paktën 30 cm, deri në dalje në dukje të muraturës, për vendosjen e guainës.

Prishja e mureve të gurit

Prishje e plote ose e pjesshme e muraturës së gurit edhe nëse është e suvatar, e çfarëdo forme ose trashësie, duke filluar nga lart poshtë, e kryer me çfarëdo lloji mjeti (mekanizma, vegla) dhe çfarëdo lartësie ose thellësie, duke përfshirë skelën e shërbimit ose skelerinë, armaturat e mundshme për të mbështetur ose mbrojtur strukturat ose ndërtesat përreth, riparimi për dëmet të shkaktuara ndaj të tretëve. Ndërprerjet dhe restaurimin normal të tubacioneve publike dhe private (kanalet e ujrave të zeza, ujin, dritat etj...), si dhe vënien mënjane dhe pastrimin e gurëve për përdorim, duke bërë sistemimin brenda ambientit të kantierit. Gjithashtu, edhe çdo detyrim tjetër që siguron plotësisht prishjen.

Prishja e mureve të tullës

Prishje e muraturës me tulla të plota ose me vrima, e çfarëdo lloji dhe dimensionit, edhe e suvatar ose e veshur me majolikë, që realizohet me çfarëdo lloji mjeti dhe e çfarëdo lartësie ose thellësie, përfshirë skelën e shërbimit ose skelerinë, armaturat e mundshme për të mbështetur ose mbrojtur strukturat ose ndërtesat përreth, riparimi për dëmet e shkaktuara ndaj të tretëve për ndërprerjet dhe restaurimin normal të tubacioneve publike dhe private (kanalet e ujrave të zeza, ujin, dritat etj...), si dhe vënien mënjane dhe pastrimin e gurëve për përdorim, duke bërë sistemimin brenda ambientit të kantierit. Gjithashtu, edhe çdo detyrim tjetër që siguron plotësisht prishjen.

Prishja e dyshemeve

Prishja e dyshemeve të çfarëdo lloji dhe spostimin e materialeve, jashtë ambientit të kantierit

Prishja e veshjeve me pllaka të mureve

Prishje e veshjeve të çfarëdo lloji dhe prishje e Llaçit që ndodhet poshtë, pastrim, larje, duke përfshirë largimin e materialeve jashtë ambientit të kantierit, si dhe çdo detyrim tjetër.

Heqja e dyerve dhe dritareve

Heqje dyersh dhe dritaresh, që realizohet para prishjes së murit, duke përfshirë kasën, telajot, etj Sistemimin e materialit që ekziston brenda ambientit të kantiërit. dhe grumbullimin në një vend të caktuar në kantier për ripërdorim.

Heqja e zgarave metalike

Heqja e zgarave të hekurit dhe sistemimin e materialit që rezulton, brenda ambientit të kantiërit, duke përfshirë përzgjedhjen e mundshme (të përcaktuar nga D.P.) dhe vënien mënjane në një vend të caktuar të kantierit për ripërdorim.

SPECIFIKIMET TEKNIKE

KAPITULLI 12

PUNIME TERITORI

SEKSION 13 PUNIME TERRITORI

RRUGË

NËN-BAZA DHE BAZA

SHTRIMI

KULLIMET DHE DRENAZHIMI

SHENJAT RRUGORE DHE TABELAT

PARKINGJET

NËN-BAZA DHE BAZA

SHTRIMI

SHENJA DHE TABELA

SHTRIMI I TROTUAREVE

SHTRIM ME PLLAKA BETONI

BORDURA BETONI PËR TROTUARE

PEISAZHI

NIVELIMI DHE PËRGATITJA E TERRENIT

MBJELLJA DHE PLEHËRIMI

SISTEMI UJITËS

GARDH DHË PORTAT

GARDH ME MUR DHE KANGJELLA

DERË METALIKE

TERRENE SPORTIVE

TERRENE TË FORTA (BETON, ASFALT)

TERRENE TË BUTA (BAR, RËRË, SKORJE ETJ)

TERRENE TË VESHURA ME MATERIAL PVC

SEKSION 13 PUNIME TERRITORI

Rrugë

Nën-baza dhe baza

Nën-baza nënkupton truallin mbi të cilën do të vendoset baza dhe shtrimi i rrugës. Baza duhet ti plotësojë nevojat dhe kushtet e punimeve të dheut si janë të përshkruara në zërin 6 (3.1). Nën-baza duhet të rrafshohet dhe të ngjeshet me një tolerancë maksimale prej +/- 3 cm. Duke e punuar nënbazën duhet marrë parasysh edhe pjerrësia.

Baza është shtresa mbajtëse e rrugës. Ajo duhet të punohet në këtë mënyrë: Pasi të hiqet dheu me një thellësi përafërsisht prej 30 cm (deri në nënbazën), ai duhet mbushur me një material zhavor 0/32 mm deri në 0/56 mm. Materiali do të vendoset në shtresa dhe do të ngjeshet mirë. Pjerrësia prej më së paku 1 % duhet të mbahet edhe gjatë vendosjes së bazës.

Shtrimi


Shtrimi i rrugëve nëpër oborrin e shkollës preferohet të bëhet me pllaka guri, beton si dhe beton monolit. Këto punë do të bëhen në këtë mënyrë:

Përmbi bazën do të vendohet një shtresë rëre me një trashësi maksimale prej 5 cm mbi të cilën do të vendosen pllakat e gurit. Shtresa e rërës duhet të jetë me kokriza 2/5 mm deri 0/4 mm. Ajo do të rrafshohet dhe mbi atë duhet të vendosen pllakat e gurit ose betonit.

Mbas vendosjes së pllakave ata me një makinë të posaçme do të tunden në atë mënyrë që të arrihet një rrafshësi perfekte. Më në fund fugat e pllakave do të mbushen me një rërë të imët 0/1 mm në atë mënyrë që pllakat të lidhen më së miri njëra me tjetren dhe të përforcohet/stabilizohet shtresa e pllakave të gurit ose betonit.

Karakteristikat e pllakave të gurit dhe betonit duhen marrë prej prodhuesve. Ato variojnë si në trashësi ashtu edhe në dimensionet e tjera. Po ashtu edhe ngjyrat e tyre janë të ndryshme. Arkitekti/Supervizori së bashku me klientin duhet të bien në marrëveshje ndaj modelit, dimensioneve dhe ngjyrës së pllakave.

Në figurën e mëposhtme paraqiten shtresat e një rruge të këtij tipi.



Kullimet dhe drenazhimi

Në rast të përdorjes të sistemit të rrugës të lartpërmendur (me pllaka guri, betoni), nevojat për planifikimin e kullimeve dhe drenazhimeve janë minimale.

Pllakat e gurit, betonit me sistemin e lartë të fugave nuk kanë nevojë për ndonjë kullim ose drenazhim. Shiu do të depërtojë nëpër fuga. Në raste se shiu është shumë I fuqishëm, për ato raste rrugët duhet të vendosen me një pjerrtësi prej më së paktu 1 %. Pjerrtësia e rrugëve bëhet prej njëres anë të rrugës deri në anën tjetër.

Shenjat rrugore dhe tabelat


Shenjat rrugore si dhe tabelat e nevojshme duhet të vendosen në një mënyrë të qëndrueshme që të mos rrëzohen nga era ose nga forca të tjera (në rast se fëmijët varen tek ato).

Ata duhet vendosur në një gropë me dimensionet më së pakti 30 x 30 x 40 cm, në të cilën futet tuba prej metali dhe gropa mbushet me beton.

Shenjat ose tabelat të cilët ngjiten në tub duhet të jenë më së pakti 2,25 m lartësi nga sipërfaqja.

Se cilat shenja/tabela duhet të vendosen, varet prej nevojave dhe arkitekti duhet të vendosë për ato si dhe nga rregullorja e qarkullimit rrugor.

Në fotografinë e mëposhtme janë dimensionet në cm të cilat duhen paraparë për rrugët.



Parkinget

Të përgjithshme

Numri i vendeve për parkim duhet paraparë sipas nevojave që do të ekzistojnë lidhur me projektin dhe objektin. Ai do të caktohet nga arkitekti/Supervizori gjatë fazës së projektimit. Numri i parkingeve në shkolla është i varur vetëm nga numri i mësuesve dhe shkallën e tyre të motorizimit. Në rast se nuk ka vend të mjaftueshëm për parkinget, ato nuk duhet të projektohen në vend të infrastrukturës tjetër (si psh rrugët, parket, pejsazheve, etj.).

Nën-baza dhe baza

Nën-baza nënkupton truallin mbi të cilën do të vendoset baza dhe shtrimi i rrugës. Baza duhet ti plotësojë nevojat dhe kushtet e punimeve të dheut si janë të përshkruara në zërin 6 (3.1). Nën-baza duhet të rrafshohet dhe të ngjeshet me një tolerancë maksimale prej +/- 3 cm. Duke e punuar nën-bazën duhet marrë parasysh edhe pjerrësia.

Baza është shtresa e cila është baza bajtëse e rrugës. Ajo duhet të punohet në këtë mënyrë: Pasi të hiqet dheu me një thellësi përafërsisht prej 30 cm (deri në nën-bazën), ai duhet mbushur me një material zhavor me granolometri 0/32 mm deri në 0/56 mm. Materiali do të vendoset në shtresa dhe do të ngjeshet mirë. Pjerrësia prej më së paktu 1 % duhet të ruhet edhe gjatë vendosjes së bazës.

Shtrimi

Shtrimi i parkingeve bëhet me të njëjtën material si shtrimi i rrugëve (i përshkruar në pikën 7.1.2) ose me beton monolit dhe me asfaltobeton.

Në rast se përdoret ndonjë lloje tjetër shtrimi të parkingut, atëhere duhet ndjekur rekomandimet e projektuesit/Supervizorit dhe punimet duhet të bëhen sipas kërkesave teknike që rekomandojnë ata.

Shenja dhe tabela

Njëlloj si tek pika 7.1.4.

Shtrimi i trotuarëve

Shtrimi i trotuarëve mund të bëhet me mënyra të ndryshme. Pavaresisht prej mënyrës së shtrimit, baza dhe nënbaza duhet gjithmone ti plotësojë kushtet e nevojshme teknike përsa i përket ngjeshjes dhe materialit të mirë.

Riparim trotuari me pllaka betoni

Kur flitet për riparimin e pllakave te betonit duhet ndarë dy lloje riparimi:

Riparimi i një sipërfaqeje jo të rrafshët.

Riparimi/ndërimi i një ose më shumë pllakave

Riparimi i trotuarëve me pllaka betoni duhet të bëhet në këtë mënyrë:

Në rast se duhet të ndërrohen pllakat e dëmtuara, atëherë duhet ato të hiqen dhe të zhvendesohen me pllaka të reja të njëjtit produkt me të njëjtat veçori. Pllaka e re duhet të goditet me fundin çekiçit me kujdes që të mos dëmtohet, derisa të hyjë në nivelin e duhur dhe pastaj fugat duhet të mbushen si më parë.

Në rast se është sipërfaqja jo e rrafshët, atëherë duhet të hiqen pllakat e betonit në atë masë sa është vëndi i dëmtuar. Në raste dëmtimi edhe të nën bazës në një sipërfaqe të madhe, baza ndër pllakat e betonit duhet mbushur dhe ngjeshur mirë, e pastaj të vendosen përsëri pllakat në mënyrën e lartëpërmendur.

Shtrim me pllaka betoni

Shtrimi me pllaka betoni është përshkruar gjerësisht në pikat 7.1.1 deri 7.1.4.

Bordura betoni për trotuarë

Trotuarët, rrugët si dhe pjesët e tjera të shtruara prej asfalti, pllakave të betonit ose prej ndonjë materiali tjetër duhet që të mbrohen në atë mënyrë, që anëve t'u vendoset nga një mbështetëse.

Bordura mbështetëse duhet të plotësojë kërkesat e lartëpërmendura për të mbajtur sipërfaqen e shtruar prej forcave horizontale, të cilat shkaktohen nga lëvizja e forcave vertikale, prej makinave, njerëzve, etj.

Një funksion tjetër që u shtohet atyre, është që të drejtojnë ujrat e rrugës.

Bordurat mund të vendosen në të njëjtën lartësi me sipërfaqen e shtruar ose të jenë nga 10 cm deri në 30 cm më lartë nga rruga sipas nevojës.

Materiali i bordurave duhet të jetë prej betoni ose prej guri. Zgjedhja e tij duhet bërë nga arkitekti/Supervizori së bashku me klientin dhe duhet pasur parasysh se materiali i zgjedhur luan një rol të veçantë në dekorimin e sipërfaqeve.

Materialet që i ofron tregu janë të këtij lloji:

Bordura prej betoni në dimensionet e ndryshme. Ata janë pjesë të parapërgatitura prej betoni dhe duhet të instalohen sipas mënyrës së përshkruar më poshtë. Në tabelën e mëposhtme janë paraqitur disa lloje të bordurave prej betoni me karakteristikat e tyre.

Nr.	Bordurat në cm (gjatësi/trashësi/lartësi)	Pesha kg/Stk	Nevoja për 1 m
1	Përmasat 100/8/20	36	1
	Përmasat 1/3 e gurit 33/8/ 20	12	3
2	Përmasat 100/10/20	46	1

	Përmasat 1/3 e gurit 33/10/ 20	15	3
3	Përmasat 100/12/20	50	1
	Përmasat 1/3 e gurit 33/12/20	17	3
4	Përmasat 100/18/20	80	1
	Përmasat 1/3 e gurit 33/18/20	26	3
5	Përmasat 100/18/25	95	1
	Përmasat 1/3 e gurit 33/18/25	31	3
6	Përmasat 100/20/15	64	1
	Përmasat 1/3 e gurit 33/20/15	21	3

Një lloj tjetër guri që mund të përdoret në të njëjtën mënyrë si bordurat e lartpërmendura, janë tipi i „gurë bordurave“ prej betoni. Me ata mund të realizohen kthesa e harqe të ndryshme.

Në fotografinë e mëposhtme janë paraqitur dy lloje të atij tipi. Montimi i tyre bëhet në të njëjtën mënyrë si bordurat e betonit të lartpërmendur.



Gurë bordurë
Format 120 x 180 mm
Lartësia 600 mm, 800 mm,
1000 mm 1300 mm




Gurë bordurë
Format 120 x 120 mm
Lartësia 400 mm

Të njëjtat bordura që janë të lartpërmendura ekzistojnë edhe prej guri sipas granitit. Ata i plotësojnë të njëjtat funksione si bordurat prej betoni. Dimensionet e atyre varen prej tregut ofrues dhe duhet pyetur. Por si zakonisht ata i kanë pothuajse të njëjtat dimensione si ata prej betoni.

Montimi i bordurave bëhet në këtë mënyrë:

Bordurat duhet të vendosen para se të bëhet shtrimi i sipërfaqes. Për të bërë atë duhet hapur një kanal në dhe me dimensionet sipas nevojës. Kanali duhet të jetë të paktën në secilën anë nga 10 cm më i madh se bordurat. Në atë futet beton i thatë (i lagur pakë) dhe bordurat vendosen mbi atë. Nevoja e betonit është rreth 0,05 m³ beton. Në secilën anë të bordurave duhet vendosur beton në atë mënyrë që ai të fiksohet mirë dhe fortë.

Në fotografitë e mëposhtme është paraqitur skema e montimit të bordurave si dhe një shembull i një rruge me bordura guri prej graniti.



Pejsazhi (sistemimi i terrenit)
Nivelimi dhe përgatitja e terrenit

Për punimet e pejsazhit duhet të kontaktohet një specialist i posaçëm, i cili do të bëjë planet dhe do të japë instruksionet për punimet. Megjithatë është e nevojshme edhe për disa kërkesa, të cilave duhet të kemi parasysh.

Nivelimi dhe përgatitja e terrenit

Nivelimi i terrenit duhet të bëhet sipas nevojës, formës së tij dhe mjeteve financiare. Në raste se ka vetëm detyrën e dekorimit, atëherë ai mund të lihet në atë formë që ekziston.

Pa marrë parasysh nivelimin e terrenit, ai duhet të përgatitet në atë mënyrë, që të garantohet mirëmbajtja e pejsazhit. Në rast të mungesës së tokës së mirë (humus), duhet sjellë humus nga ndonjë vendi tjetër dhe të shtrohet me një shtresë min. 20 cm ose sipas projektit.

Në rast se terreni ka shumë gurë, atëherë mund të ketë nevojë për një shtresë më të madhe të shtresës së humusit.

“INVICTUS” sh.p.k.
Ing. Andrin KERPACI

Ing. Laerta LIKO

ANALIZA ÇMIMESH

OBJEKTI: "RIKONSTRUKSION RRUGA "HAFIZ ALI ULQINAKU", BASHKIA SHKODËR

OBJEKTI: "RIKONSTRUKSION DEGËZIME RRUGA E SHIROKËS" BASHKIA SHKODËR

Nr. Analize	E M E R T I M I	Njesia	op	PUNTORI		TRANSPORT			MAKINERI			MATERIAL			Shuma	Shp		TOTALI
				çmimi	Vlefte	T/km	çmimi	Vlefte	o.p	çmimi	Vlefte	Sasia	çmimi	Vlefte		pl	Fitim	
1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	13	14	15	16	17	18	19
Anal - 1	Mbingritje pusetash	cope																
	Sp + p	op	4.1	185	759													
	Sigurime shoqerore 16.7%	leke	758.5	0.167	127													
	Transport	T*km				10.5	21	220.5										
	Vibrator	op							1.5	53	79.5							
	Shtrese zhavori	m3										0.22	913	201				
	Shtrese beton C 12/15	m3										0.35	6930	2425.5				
	Mur betoni C 12/15	m3										0.54	8000	4324				
Shuma :				885			221			80			6951	8136	651	814	9600	
Anal - 10	F.V.Tabela <0,5 m 2 me dy tuba	cope																
	Sp + p	op	0.5	185	93													
	Sigurime shoqerore 16.7%	leke	92.5	0.167	15													
	Tabela <0,5 m 2 me dy tuba	leke										1	12604	12604				
Shuma :				108									12604	12712	1017	1271	15000	
Anal - 11	F.V.Tabela Fig 37 STOP	cope																
	Sp + p	op	0.5	185	93													
	Sigurime shoqerore 16.7%	leke	92.5	0.167	15													
	Tabela Fig 37 STOP	leke										1	8367	8367				
Shuma :				108									8367	8475	678	847	10000	

OBJEKTI: "RIKONSTRUKSION DEGËZIME RRUGA E SHIROKËS" BASHKIA SHKODËR

Nr. Analize	E M E R T I M I	Njesia	op	PUNTORI		TRANSPORT			MAKINERI			MATERIAL			Shuma	Shp		TOTALI
				çmimi	Vlefte	T/km	çmimi	Vlefte	o.p	çmimi	Vlefte	Sasia	çmimi	Vlefte		pl	Fitim	
1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	13	14	15	16	17	18	19
Anal - 12	Vijezim anesor 15 cm, me boje bikomponente	ml																
	Sp + p	op	0.1	185	19													
	Sigurime shoqerore 16.7%	leke	18.5	0.167	3													
	Sperkates boje	op							0.1	300	30							
	Boje bikomponente	kg										0.2	1368	274				
	Shuma :				22						30			274	325	26	33	384
Anal - 13	Banda kembesoresh (90 cop,200*50 cm) me boje bikomponente	m2																
	Sp + p	op	0.2	185	37													
	Sigurime shoqerore 16.7%	leke	37	0.167	6													
	Sperkates boje	op							0.1	300	30							
	Boje bikomponente	kg										0.84	1368	1142				
	Shuma :				43						30			1142	1215	97	122	1434
Anal - 14	Vijezim ne korsi ne nje sens te shpejtesise se lejuar se levizjes se mjeteve	cope																
	Sp + p	op	0.25	185	46													
	Sigurime shoqerore 16.7%	leke	46.25	0.167	8													
	Sperkates boje	op							0.1	300	30							
	Boje bikomponente	kg										0.83	1368	1131				
	Shuma :				54						30			1131	1215	97	121	1434
Anal - 17	F V tuba te brinjezuar HDPE SN8 d=250 mm	ml																
	Sp + p	op	1.5	185	278													
	Sigurime shoqerore 16.7%	leke	278	0.167	46													
	Tub HDPE SN8 d=250mm	ml										1	954.852	955				
	Rakorderi HDPE SN8 d=250mm	cope										0.1	743	74				
	Rere per mbrojtjen e tubit	m3										0.15	870	131				
	Materiale te ndryshme 2 %											955	0.02	19				
	Shuma				324									1179	1503	120	150	1,773

RAPORTI V.N.M.

OBJEKTI: "RIKONSTRUKSION RRUGA "HAFIZ ALI ULQINAKU", BASHKIA SHKODËR

PERMBAJTJA

1. HYRJE

2. KUADRI POLITIK, LIGJOR DHE ADMINISTRATIV

- 2.1 Politika.
- 2.2 Baza Ligjore.

3. PERSHKRIMI I PROJEKTIT

- 3.1 Pozicioni gjeografik.
- 3.2 Statusi i zones se studiuar dhe objektvi i projektit.
- 3.3 Infrastruktura rrugore e zones dhe rruget ndihmese.

4. TREGUESIT TEKNIKE TE PROJEKTIT DHE KOSTOJA E PROJEKTIT

5. EKONOMIA E ZONES DHE AKTIVITETET KRYESORE TE SAJ

- 5.1 Statusi i zones ne studim.
- 5.2 Variantet e zhvillimit ne perspektve.
- 5.3 Mendimi i komunitetit.
- 5.4 Planet e zhvillimit urban te zones.
- 5.5 Ekosistemet, habitatet dhe pesazhi ekzistues.
- 5.6 Trashegimia arkitektonike dhe historike.

6. METODIKA E VLERESIMIT TE NDIKIMEVE NE MJEDIS

- 6.1 Objektivat dhe qellimi i V.N.M.-se.
- 6.2 Metodika e kryerjes se V.N.M.-se.
- 6.3 Identifikimi i ndikimeve ne mjedis nga zbatimi i projektit.

7. ANALIZA E GJENDJES EKZISTUESE DHE VLERESIMI I SITUATES

- 7.1 Ndikimet ne mjedis gjate rikonstruksionit te degezimeve.
- 7.2 Ndikimet ne mjedis gjate pregatitjes se strukturave te rikonstruksionit.
- 7.3 Ndikimet ne mjedis gjate largimit te materialeve nga germimet, etj.
- 7.4 Ndikimet ne mjedis si rezultat i sjelljes se materialeve te ndryshme ne kantier.
- 7.5 Vleresimi i efektivitetit te pritshem te masave zbutese.
- 7.6 Zhurmat.
- 7.7 Ndikimet ne ujrat nentokesore.

8. PLANI I ZBUTJES SE NDIKIMEVE NEGATIVE

- 8.1 Perdorimi tokes.
- 8.2 Ndikimi tek njerezit, ndertesat dhe objektet e ndertuara nga njeriu.
- 8.3 Ndikimet e rikonstruksionit te degezimeve mbi trashgimine arkitektonike dhe historike, tiparet arkeologjike, si dhe vepra te tjera njerezore.

8.4 Ulja e intensitetit te erozionit dhe zbutja e ndryshimeve te topografise.

9. NDIKIMET NE FLORE, FAUNE DHE GJEOLOGJINE

9.1 Bimet e ujit

9.2 Flora dhe Fauna

10. NDIKIMET E PRITSHME NE MJEDISIN PERRETH

10.1 Ndikimet fizike te projektit ne ndryshimet e topografise se zones, tokes, etj.

10.2 Ndikimet e projektit ne modelin drenazhues te zones

10.3 Ne cilesine dhe sasine e tokes

10.4 Ndikimet ne uje

10.5 Ndikimet e ndotesve dhe mbetjeve ne cilesine e ujit

10.6 Ndikimet ne ajer

10.7 Ndikimi ne klime

10.8 Aromat sulmuese

10.9 Ndikime te tjera klimatike

10.10 Ndikime te tjera indirekte dhe sekondare, qe shoqerojne projektin

10.11 Ndikimet shoqeruese te projektit me projekte te tjera ekzistuese e te propozuara

11. MASAT PER ZBUTJEN E NDIKIMEVE NE MJEDIS GJATE ZBATIMIT TE PROJEKTIT

11.1 Organizimi

11.2 Masat e sigurimit teknik ne pune

11.3 Mbrojtja e mjedisit

11.4 Masat e mara per zbutjen e rrezikut ne mjedis dhe shendet

12. MATRICAT PERMBLEDHESE TE NDIKIMEVE NE MJEDIS

13.1 Matrica e ndikimeve ne mjedis

13.2 Matrica e prioriteteve te ndikimeve ne mjedis gjate fazes se ndertimit dhe shfrytezimit

13. ASPEKTET NEGATIVE DHE POZITIVE TE NDIKIMIT NE MJEDIS

14.1 Efektet negative

14.2 Efektet pozitive

14. PROGRAMI I MONITORIMIT TE NDIKIMIT NE MJEDIS TE PROJEKTIT

15.1 Plani i monitorimit

15.2 Programi i monitorimit

15.3 Plani i monitorimit gjate operimit

15. KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME

1. HYRJE

Rruga "Hafiz Ali Ulqinaku", ndodhen ne qytetin e Shkodres. Qëllimi i projektit konsiston në rikualifikimin e rrugës, krijimin e hapësirave më miqësore për funksionimin e kësaj rruge si infrastrukturë e mirëfilltë bashkëkohore dhe kthimin e saj në shërbim të komunitetit. Ndërhyrja në rrjetin nëntokësor, mbitokësor dhe në gjelbërim, rrit cilësinë dhe sigurinë e jetës së banorëve.

Shqipëria ka nenshkruar dhe është zbatuese e rregullt e nje numri Konventash Nderkombetare (Barcelona, Ramsari, Konventa e Biodiversitetit, etj), dhe tashme ka nje pakete te plote ligjore per masat mbrojtese te mjedisit dhe vleresimit te impaktit ambjental te veprimtarive, sherbimeve apo ndertimeve ne mjedisin veprues.

Ky kuader ligjor dhe angazhimet nderkombetare ne fushen e mjedisit, shtrojne shume detyra ndaj institucioneve per te zbatuar nje sistem sa me efektiv per administrimin e mjedisit, jo vetem ne drejtim te zgjidhjes se problemit per ritjen e investimeve publike per rritjen e cilesise se jeteses se zones ku zhvillohet projekti, por dhe zbatimit e pergjegjesive te rrjedhin nga keto marreveshje. Vendi yne duke qene anetar i nje numri konventash, detyrohet te zbatoje nje sistem sa me efektiv ekonomik, social-mjedisor, per rregullimin e territorit, sidomos ne funksion te zgjidhjes se problemeve te ndryshme mjedisore.

Ne zhvillimin ekonomik-shoqeror te nje vendi, gjithnje ne perputhje me parimin universal te zhvillimit te qendrueshem, marrin rendesi te vecante gjetja e rrugëve dhe teknologjive me efikase, si per shfrytëzimin sa me racional te pasurive natyrore, ashtu edhe per kontrollin cilësor dhe sasior të ajrit, tokës dhe ujërave.

Gjate dekadave te fundit veprimtari te ndryshme kane ndikuar dukshem ne mjedisin rrethues ne pergjithesi, dhe ne ate ujqor ne veçanti. Shkarkimet e ujërave te perdorura urbane dhe industriale ne liqene, lumenj dhe dete jane tashme nje dukuri e rendomte, te cilat ne menyre progresive kane ndikuar ne demtimin e cilesise se mjedisit ne brigjet e tyre. Nga nderimi i rrugëve dhe objekteve ose shfrytëzimi, karierave dhe minierave siperfaqesore nuk jane kryer rehabilitimet e nevojshme ne raport me shfrytëzimin e tokës natyrore, shpesh here keto ndikime te njohura por edhe te panjohura, jane me te dukshme ne impaktin qe kane ne shendetin e njeriut dhe ne mjedisin ne pergjithesi.

Rikonstruksioni i Rrugës “Hafiz Ali Ulqinaku” sipas standarteve bashkohore te nje vendi qe aderon te behet anetar i BE, është teper i rendesishem per aktivitetin normal te tij. Per kete qellim nderhyrja, me synim reabilitimin dhe ritjen e nivelit te jeteses te tij, duhet koordinuar me aktivitete te tjera jetesore dhe ekonomike te zones.

Vemendje e veçante duhet te kete sidomos:

- kur punimet kryhen afer qendrave te banuara,
- kur keto investime rrisin punesimin dhe sjellin zhvillim per aktivitetet ekonomike perreth tij,
- kur ka objekte turistike qe jane te lidhur me nevojat per higjene,
- kur jane zona qe kane nje status te vecante, etj.

Ne Ligjin me Nr. 10440, datë 07. 07. 2011 “Per Vleresimin e Ndikimit ne Mjedis” (V.N.M.) është dhene ne menyre te qarte se cilat projekte i nenshtrohen vleresimit te ndikimit ne mjedis te cilat klasifikohen si me poshte:

1. Procesit te vleresimit te ndikimit ne mjedis (V.N.M.) i nenshtrohen gjithë projektet e veprimtarite, qe jepen ne shtojcat 1 dhe 2 te ketij ligji, para miratimit tyre nga organet perkatese.
2. Projektet e veprimtarite i nenshtrohen dy niveleve te shqyrtimit per vleresim ndikimi ne mjedis:

a) Procesit te thelluar te vleresimit te ndikimit ne mjedis nenshtrohen projektet e shtojces 1 dhe projektet e veprimtarise qe kerkojne te zbatohen ne nje zone te mbrojtur.

b) Procesit te permbledhur te vleresimit te ndikimit ne mjedis (V.N.M.), te cilit i nenshtrohen projektet e shtojces 2 dhe ndryshimet ose rikonstruksionet e projekteve te shtojces 1.

Ne respektim te percaktimeve ne Ligjin Nr. 10440, datë 07. 07. 2011 “Per Vleresimin e Ndikimit ne Mjedis” dhe Udhezimin Nr.6, date 27.12.2006 “Per miratimin e metodologjise se vleresimit te ndikimit ne mjedis te nje veprimtarie”, me investitor Bashkia Shkoder, e cila eshte ne fazen e hartimit te projektit te zbatimit.

TAB 1. KLASIFIKIMI I RAPORTIT TE VLERESIMIT NE MJEDIS PER PROJEKTIN E “RIKONSTRUKSION I RRUGES “HAFIZ ALI ULQINAKU” ”

Pyetje qe duhen marre parasysh per klasifikimin gjate projekt-zbatimit apo ushtrimit te veprimtarise:	Pershkruaj shkurtimisht Po / Jo	Do te kete nderveprim / ndikim te rendesishem? Po / Jo - Perse?
1. Do te shkaktohen ndryshime fizike ne territor (ne topografine, perdorimin e tokes ose burimet ujore etj.)?	Po (punimet jane per rikonstruksion rruges)	Jo (rehabilitimi i rrugeve nuk ka ndikim te rendesishem ne mjedis pasi rruget jane ekzistuese dhe ne perfundim do te ulet ndotja)
2. Do te perdoren burimet natyrore si: toka, uji, materiale ose energji, vecanerisht ato burime qe nuk jane te rinovueshme ose me pakice?	Po (toka midis e rrugeve ekzistuese)	Jo (Siperfaqja eshte ekzistuese dhe nuk ndryshon destinacion por vetem sistemohen rrjetet inxhinierike dhe asfaltohen rruget)
3. Parashikohet perdorimi, magazinimi, transporti apo prodhimi i substancave ose materialeve te demshme per shendetin dhe mjedisin?	Jo	
4. Do te prodhohen mbetje te ngurta?	Po (gjate germimit per rehabilitimin e shtresave te rruges)	Jo (mbetjet do te trajtohen ne perputhje me VKM 575, date 24.06.2015 ne vendin e miratuar nga njesia vendore)
5. Do te kete shkarkime ne ajer te ndotesve, substancave te rrezikshme, toksike ose helmuese?	Jo	
6. Do te kete zhurma e vibrime apo clirime drite, energjie ose rrezatim elektromagnetik?	Po (zhurma e vibrime gjate punimeve te rruges)	Jo (do te punohet me orare te reduktuara 7 ⁰⁰ -16 ⁰⁰)
7. Do te kete rrezik per ndotjen e tokes e ujerave nga shkarkimi i ndotesve ne siperfaqen e tokes, ujerave siperfaqesore, nentokesore, bregdetare ose ne det?	Jo	
8. Ka rrezik per aksidente qe ndikojne ne shendetin e njerezve apo ne mjedis?	Po (gjate ndertimit)	Jo (do te respektohen rregullat e sigurimit teknik ne pune)
9. Do kete ndikime sociale, demografike, menyra tradicionale jetese, punesim etj?	Po(sociale, demografike, menyra tradicionale jeteses, punesim)	Po (impakt pozitiv pasi rehabilitimi i rrugeve ndikon ne permiresimin e te gjithë ketyre faktoreve)
10. Ka faktore te tjere qe duhen marre ne konsiderate si zhvillime qe cojne ne pasoja mjedisore apo mundesi per mbivendosje ndikimesh te ndryshme nga veprimtari ekzistuese ose te planifikuara ne zone?	Jo	
11. Ka zona te mbrojtura nga legjislatoni nderkombetar/kombetar per vlerat e tyre ne biodiversitet, ekologji, peizazh, vlera kulturore, historike e arkeologjike?	Jo	
12. Ka zona te ndjeshme mjedisore, si zona bregdetare, male, pyje, kullota, flore, faun e eger, dru frutore ne zone?	Jo	
13. Ka zona me specie te mbrojtura, te rendesishme ose te ndjeshme, rrezikuara, kercenuara, ne rrezik zhdukje te faunes e flores, p.sh. per kryqezime, folenizime, pushime, dimerime, migrime etj. ne zone?	Jo	
14. Ka zona me ujera tokesore, nentokesore apo detare ne zone?	Jo	
15. Ka zona me tipare te spikatura panoramike ose skenike ne zone?	Jo	
16. Ka rruge a infrastruktura te ngjashme qe perdoren nga publiku per te shkuar ne vende pushimi etj. ose rruge	Po (Rruge te cilat do te bllokohet perkohesisht	Jo (nuk ka ndikim te rendesishem pasi do te lihen mundesi per emergjencat dhe do te jene

transporti te mbingarkuara qe mund te ndikohen?	gjate punimeve)	punime provizore te cilat do te kryhen me radhe per rrugen duke lejuar levizjen)
17. Ka perdorime ekzistuese te tokes (banime, industri, tregti, pushim, bujqesi, pyje, turizem, zona te gjelbra, sportive, argetuese, prona te tjera private etj.) ose plane te ardhshme qe ndikohen?	Po (banime)	Po (ka ndikim pozitiv te rendesishem pasi rritet niveli i jeteses dhe sherbimeve)
18. Eshte zona nen rrezikun e ndotjes ose demtimeve mjedisore ku standartet mjedisore jane tejkaluar?	Jo	
19. Eshte zona me probleme sa i perket termeteve, rreshqitjes se dherave, erozionit, permbytjeve, koshteve ekstreme klimatike (ndryshime te temperatures, mjegulla erera te forta)?	Jo	

2. KUADRI POLITIK, LIGJOR DHE ADMINISTRATIV

2.1 Baza Ligjore

Ndergjegjsimi ne Shqiperi eshte i nje niveli te ulet, kjo si rrjedhoje e nje legjislaciani mjedisor relativisht te ri qe eshte ne zhvillim dhe po plotesohet me tej sidomos me rregullore dhe standarte. Aplikimet per V.M.M. kane si detyrim paketen ligjore te meposhteme:

- Udhezues Metodik i Ministrise se Mjedisit, Tirane, “Per Pergatitjen e Raportit te Vleresimit Ndikimit ne Mjedis”
- Urdherin e Ministrit Nr. 137, date 17.08.2004. “Per Dokumentacionin e Domosdoshem per Leje Mjedisore”.
- Ligj Nr. 9385 date 4.5.2005 “Per pyjet dhe sherbimin pyjor”
- Ligji me Nr. 9587, dt 20.07.2006 “Per Mbrojtjen e Biodiversitetit i Ndryshuar”
- Udhezimin me Nr.6, date 27.12.2006 “Per miratimii e metodologjise se vleresimit paraprak te ndikimit ne mjedis te nje veprimtarie”.
- Ligji me Nr. 10006, dt 23.10.2008 “Per mbrojtjen e Faunes se Eger”
- Ligji me Nr.10431, Datë 09.06.2011 “Për Mbrojtjen e Mjedisit”.
- Ligji me Nr.10440, Datë 07.07. 2011 “Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis”.
- Ligji me Nr. 10448, Datë 14.07.2011, “Për Lejet e Mjedisit”.
- Ligj me Nr.10463, Datë 22.09.2011 “Për Menaxhanimin e Integruar te Mbetjeve” i ndryshuar
- Ligji me Nr. 111/2012, date 03.12.2012 “Për Menaxhimin E Integruar të Burimeve Ujore”.
- Ligji me Nr. 60/2014 për një ndryshim në ligjin Nr. 10448, Datë 14.07.2011, “Për Lejet e Mjedisit”, të ndryshuar.
- Ligji me Nr. 8906, Datë 06.06.2002, “Për Zonat e Mbrojtura”, të ndryshuar.
- Vendim Nr. 13, datë 04.01.2014 për miratimin e rregullave, të përgjegjësave e të afateve për zhvillimin e procedurës së V.N.M.
- V.K.M. me Nr. 247, date 30.04.2014 “Per percaktimin e rregullave, te kerkesave e te procedurave per informimin dhe perfshirjen e publikut ne vendimarrje mjedisore”.
- V.K.M. Nr. 419, me date 25.06.2014 “Per Miratimin e Kërkesave të Posaçme për Shqyrtimin e Kërkesave për Leje Mjedisit të Tipave A, B dhe C, për Transferimin e lejeve nga një subjekt te tjetri, të kushteve për lejet respektive të mjedisit, si dhe rregullave të hollësishme për shqyrtimin e tyre nga autoritetet kompetente deri në lëshimin e këtyre lejeve nga QKL-ja
- V.K. M. me Nr. 686, date 29.07.2015 “Per percaktimin e rregullave, pergjegjese e te afateve per zhvillimin e procedures ne vleresimin e ndikimit ne mjedis (V.N.M) dhe procedures se transferimit te vendimit te deklarates mjedisore”.

- Vendim Nr. 575, Datë 24.6.2015 “Për Miratimin e Kërkesave për Menaxhimin e Mbetjeve Inerte”

Raporti i Vleresimit Ndikimit ne Mjedis perfsihin parashikimin dhe planifikimin e masave zbutese te ndikimit te projektit ne mjedisin fizik. Ky proces zhvillohet brenda atij te planifikimit dhe zbatimit te projektit, duke paraqitur prioritetet mjedisore dhe listen e veprimeve per zgjidhjen e tyre.

3. PERSHKRIMI I PROJEKTIT

3.1 Pozicioni gjeografik

Rruga "Hafiz Ali Ulqinaku", ndodhen ne qytetin e Shkodres. Qëllimi i projektit konsiston në rikualifikimin e rrugës, krijimin e hapësirave më miqësore për funksionimin e kësaj rruge si infrastrukturë e mirëfilltë bashkëkohore dhe kthimin e saj në shërbim të komunitetit. Ndërhyrja në rrjetin nëntokësor, mbitokësor dhe në gjelbërim, rrit cilësinë dhe sigurinë e jetës së banorëve.

3.2 Statusi i zones se studiuar dhe objektivi i projektit

Zhvillimi ekonomik i qytetit nuk mund të shihet i ndarë nga zona që rrethon qytetin e Shkodres. Duke qene se Shkodra njihet per vlerat e saj kulturore dhe turistike te zones pereth qytetit dhe zonave te thella malore. Aktivitete te tjera ekonomike te ketij qyteti mbeten sherbimet, ku tregtia me pakice puneson numrin me te madh te banoreve. Papunesia vazhdon te mbetet ne nivele te larta. Burimet kryesore ekonomike vazhdojne te vijne nga emigracioni ne vendet e Bashkimit Evropian.

3.3 Infrastruktura zones

Zona pershkohet nga rruget urbane te siperpermendura. Ndertimi i rruges ne afersi te qendres se qytetit te Shkodres lehteson ndjeshem punimet ndertimore dhe shfrytezimit e tij. Jane parashikuar masat per fazen e rikonstruksionit dhe per fazen e shfrytezimit jane eshte parashikuar mirembajtja e rrugeve, pemeve, ndricimit.

4. TREGUESIT TEKNIKE TE PROJEKTIT

Karakteristikat baze te degezimeve te rrugeve jane paraqitur me poshte:

1. Punimet qe do te kryhen ne rruge jane, sistemim asfaltim, sinjalistike, ndricim rrugor.
2. Rruget
3. Shtresat e rruges jane Asfalt, Binder, Stabilizant, Çakull
4. Shtesat e Trotareve jane Pllaka betoni, Rere, Stabilizant, Mbushje me zhavor.
5. Rrjeti i KUZ eshte me tuba plastik HDPE
6. Rrjeti i KUB eshte me tuba BETONI.
7. Rrjeti i ndricimit rrugor eshte me shtylla metalike
8. Sinjalistika rrugore vertikale dhe horizontale
9. Gjelberim (nese ka nevojë)

5. EKONOMIA E ZONES DHE AKTIVITETET KRYESORE TE SAJ

5.1 Statusi i zones ne studim

Ne zone, historikisht dhe tradicionalisht, gje qe vazhdon edhe sot, ka gjetur zhvillim tregtia dhe zanate te tjera qe banoret e rruges zoterojne per te siguruar jetesen. Nga aktivitetet e mesiperme popullsia mbulon 80-85% te nevojave ekonomike.

5.2 Variantet e zhvillimit ne perspektive

Mbeshtetur ne investimin qe do te realizohet nga Bashkia Shkoder do te kemi nje rritje te nivelit te jeteses se tre degezimeve nga ndertimi i infrastruktures rrugore.

5.3 Mendimi i Komunitetit

Per zhvillimin e ketij projekti investitori, Bashkia Shkoder i ka kushtuar nje vemendje te vecante bashkepunimit me banoret te cilet e kane kerkuar vete kete investim. Qe ne fillimin e studimeve per kete projekt, eshte marre kontakt me komunitetin ku shtrihet objekti, duke i kerkuar miratimin ne parim te projektit.

5.4 Planet e zhvillimit urban te zones

Zhvillimi i kesaj hapësire parashtron disa kerkesa dhe kushte rigoroze ndaj vendimmarresve. Projekti i Rikonstruksionit Rruga "Hafiz Ali Ulqinaku", gjithmone duke minimizuar efektet negative ne estetiken e rrugeve eshte ne perputhje me planet e zhvillimit te qytetit.

5.5 Ekosistemet, habitatet dhe peisazhi ekzistues

Rruga e siperpermendur nuk ka ndonje pejsazh terheqes dhe aktualisht nuk ka aktiviteve ekonomike. Pas rikonstruksionit do te ndryshoje pamja e rrugeve te cilat do te lidhen me investimin qe aktualisht ka nisur te kryhet ne zone.

5.6 Trashegimia arkitektonike dhe historike

Pergjate trasese se rrugeve nuk mundet te takohen objekte dhe trashegimi qe bartin vlera kulturore.

6. METODIKA E VLERESIMIT TE NDIKIMEVE NE MJEDIS

Raporti i Vleresimit te Ndikimit ne Mjedis eshte bazuar ne projektin e zbatimit qe parashikon Rikonstruksioni i Rruges "Hafiz Ali Ulqinaku. Qellimi i hartimit te raportit te vleresimit te ndikimit ne mjedis eshte marrja parasysh e faktoreve qe ndikojne ne mjedis gjate rikualifikimit te objektit dhe funksionimit te tij.

Ky raport eshte pjesa me e rendesishrne e dokumentacionit te kerkuar, ne zbatim te procedures se nevojshme gjate procesit te miratimit te lejes mjedisore. Raporti ka gjithashtu si qellim te jape nje veshtrim te pergjithshem mbi efektet ne mjedis, alternativat e mundshme dhe masat zbutese te efekteve te padeshirueshme.

Vleresimi i Ndikimit ne Mjedis (V.N.M.) eshte nje studim qe synon parashikimin e te gjitha efekteve te pritshme ne mjedis, qe do te rezultoni nga nje projekt zbatimi gjate zbatimit ashtu dhe gjate funksionimit te tij.

V.N.M.-ja perfshin gjithashtu parashikimin dhe planifikimin e masave zbutese te ndikimeve te projektit ne mjedisin fizik dhe social me qellim permiresimin e cilesise dhe qendrueshmerise se mjedisit nepermjet:

- Marrja ne konsiderate e ceshtjeve te mjedisit ne fazen e pergatitjes se projektit te zbatimit.
- Shqyrtimit te alternativave te ndryshme brenda projektit.
- Nxjerrjes ne dukje dhe vleresimit cilesor me pika te ndikimeve ne mjedis te projektit.
- Propozime te masave zbutese te ndikimit ne projekt, etj.

Qellimi i ketij Raporti te Vleresimit te Ndikimit ne Mjedis (V.N.M.), i pergatitur per rastin e Rikonstruksionit te degëzimeve Rruga "Rikonstruksionit Rruga "Hafiz Ali Ulqinaku", eshte qe te indentifikoje pasojat e mundshme negative mjedisore qe mund te krijohen gjate rikonstruksionit dhe shfrytezimit te tij. Gjithashtu nje tjetër synim i ketij Raporti te V.N.M.-se eshte te percaktoje e te rekomandoje masat tekniko-organizative per zbutjen e faktoreve negative qe ekzistojne, dhe te atyre qe krijohen gjate rikualifikimit dhe shfrytezimit te tij. V.N.M.-ja e ketij projekti eshte hartuar per te integruar mbrotjen ambientale ne jeten e perditshme, qe te udheheqe ne ndryshimin e sjelljes se komunitetit, duke u bere ne kete menyre forca shtytese e permiresimit te vazhdueshem. Metoda me e pershtateshme per vleresimin e ndikimit ne mjedis eshte ajo e list kontrollit, e cila vendos nga njera ane te gjitha burimet e mundshme te ndikimeve, dhe nga ana tjetër mbartesit e ndikimeve, si dhe parashikimin e madhesise se ndikimit.

6.1 Objektivat dhe qellimi i V.N.M.-se

Objektivat e V.N.M.-se konsistojne ne analizimin e faktoreve lokale negative te mjedisit, ne dhenien e masave zbutese per reduktimin e tyre. Qellimi i V.N.M.-se eshte, qe nepermjet vleresimit cilesor e sasior paraprak te parametrave teknike te treguesve gjeologo-inxhinjrike, te bazuara ne kritere e standarte shkencore nderkombetare, te tipizohen dhe te perzgjidhen nje sere parametrash dhe vecorish te sistemeve te siperpermendur natyrore, ne sherbim te infrastruktures mjedisore, te infrastruktures urbane si dhe shfrytezimit te zones, etj.

Ky raport ka per qellim te sherbeje:

- Si instrument per mbrotjen e mjedisit;
- Ne fuqizimin e komunitetit per veprime ne mbrojtje te mjedisit;
- Ne kontrollin e perdorimit te qendrueshem te tokes pereth rrugeve;
- Ne rritjen e mireqenies nga menaxhimi afatgjate te tokes dhe terreneve ndihmese;
- Ne mbrotje te pasojave financiare dhe social-ekonomike;
- Ne rritje te interesimit per bashkepunim dhe ne gjetjen e zgjidhjeve te reja, etj.

6.2 Metodika e kryerjes se V.N.M.-se

Studimi vleresimit te ndikimit ne mjedis u orjentua;

- nga rendesia e rikonstruksionit dhe shfrytezimit sipas standarteve bashkekohore,
- nga permbushja e kerkesave vendase dhe te huaja,
- nga vendi ku ai ndodhet, pasurite humane te zones si dhe vlerave te vecanta te tyre,
- ne idenifikimin e ndikimeve negative dhe lokale,
- marrjen e masave zbutese, duke patur parasysh ruajtjen e interesave ekonomike te investimit,
- ne masat orientuese per nje zhvillim te qendrueshem etj.

Ne kete raport identifikohen ndikimet lokale negative ne mjediset humane, si dhe eshte mare parasysh vleresimi i rrezikut. Reduktimi i ndikimeve negative, eshte nderthurur edhe me ndikime te rendesishme lokale dhe strukturore ne fazat kyesore:

- Hartimi i objektivave orientuese te raportit te V.N.M.-se;
- Mbledhja e materialit baze ekzistues dhe plotesimi i formularit perkates per kete raport, si dhe seleksionimit te tyre per perdorim.
- Verifikimi ne terren i te dhenave ekzistuese, mbledhja e te dhenave biofizike dhe humane;
- Hartimi i V.N.M.-se dhe dorezimi tek porositesi Bashkia Shkoder si dhe ne subjektet vendimarrse dhe kontrolluese te aspekteve mjedisore ne nivel lokal dhe qendror.

6.3 Identifikimi i ndikimeve ne mjedis nga zbatimi i projektit

Nga vleresimi i veçorive kryesore te projektit, dhe me investigimet ne zonen e parashikuar per rikonstruksionin e degezimeve eshte bere identifikimi dhe vleresimi i ndikimeve te mundeshme ne mjedis. Ne perputhje me Udhezimin Nr.6, date 27.12.2006 “Per miratimin e metodologjise se vleresimit paraparak te ndikimit ne mjedis te nje veprimtarie” me keto identifikime dhe vleresime eshte plotesuar tabela I e Aneksit II te ketij udhezimi per te analizuar ne menyre te detajuar vleresimet sasiore te ndikimeve ne mjedis nga zbatimi i projektit te rikonstruksionit te degezimeve:

IDENTIFIKIMI I NDIKIMEVE NE MJEDIS NGA ZBATIMI I PROJEKTIT TE “RIKONSTRUKSION I RRUGES “HAFIZ ALI ULQINAKU” ”

Nr	Pyetje qe konsiderohen ne fazen e perzgjedhjes	Po/ Jo	Cilet elemente te mjedisit mund te ndikojne/ si?	Do te jete ndikimi domethenes ne mjedis? Pse?
1. A do te perfshije ndertimi, operimi ose mbyllja e vepimtarise dhe montimi i teknologjise dhe pajisjeve veprime qe te shkaktojne ndryshime fizike ne topografi, perdorim toke, ndryshime ne trupat ujore etj ?				
